

SAOBI AZIRI - TABI

KOHA

për

Gratë



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

GRATË DHE POLITIKA E JASHTME

Diplomaci burrash

Aktualisht Kosova ka vetëm 2 gra ambasadore nga 18 vende ku ka përfaqësi diplomatike

Diplomacia në Kosovë, duket të jetë e destinuar vetëm për burrat. Së paku kështu flasin statistikët. Nga 18 vende në të cilat Kosova ka hapur ambasada, vetëm ambasada në Hungari dhe ajo në Bullgari, drejtohen nga ambasadore gra.

Nga nëntë kandidatë sa kanë konkurruar në konkursin e parë për ambasadore, vetëm Ariana Zherka-Hoxha është emëruar ambasadore në Bullgari e më pas në të njëjtën pozitë në Hungari është vendosur edhe Shkëndije Geci-Sherifi.

Por, as procesi i emërimit të grupit të dytë të ambasadorëve kosovarë nëpër botë nuk solli shenjë optimiste për gratë. Nominimet për gjashtë shtete sollën emra burrash. U dashtë të reagojë Grupi i grave deputete në Kuvendin e Kosovës në nëntor të vitit 2011 për t'u ndryshuar kjo gjendje.

"Kjo listë e ambasadorëve të propozuar përfshinë vetëm meshkuj. Madje, përveç faktit që numri i femrave në listën e ambasadorëve të propozuar është zero, tani po shkohet me një politikë minus një, ku edhe një ambasadori femër që ka shërbyer deri tani, po zëvendësohet me një mashkull", thuhet në reagimin e Grupit të Grave Deputete. Sipas këtij propozimi, ambasadorja aktuale në Bullgari, Ariana Zherka-Hoxha, pritet të zëvendësohet nga i nominuari Shpend Kallaba.

Për këtë shkak, gratë deputete, veprimin e tillë e cilësuan antikushtetues.

"Kjo është shkelje flagrante e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 24 (2)) dhe Ligjit për Barazi Gjinore (neni 3). Në veçanti neni 3.4 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh që "Organet kompetente gjatë emërimit të...anëtarëve të organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese", patëm thënë gratë deputete në reagimin e tyre.

Por, reagimi i GDD-së për zëdhënësin e MPJ-së, Artan Behrami është i parakohshëm dhe paragjykes. Madje, sipas tij Kosova aktualisht ka femra në pozita shumë të rëndësishme diplomatike.

"Shërbimi Diplomatik i Republikës së Kosovës asnjëherë nuk ka qenë më i përfaqësuar se sot nga femrat. Në shumicën e ambasadave dhe misionet konsullorë të Republikës së Kosovës punojnë femra që kanë poste të ndryshme vendimmarrëse", ka thënë Behrami.

Sido që të jetë, i ndodhur përballë presionit të grave deputete, ekzekutivit kosovar propozoi edhe tri gra për postin e ambasadorit. Ndonëse procesi i emërimit zyrtar nuk është përmbyllur, në listën e të propozuarave janë: Vjosa Dobruna (Kolumbi), Mimoza Ahmetaj (Sloveni) dhe Bukurie Gjonbalaj (Itali).

Diplomacia - e rezervuar vetëm për burra!

E qasja e tillë e burrave të Qeverisë duket të jetë konform mendimeve që kanë disa prej njerëzve që e bëjnë politikën e jashtme. Zv.ministri i jashtëm Ibrahim Gashi në një prezantim media nuk ka hezituar të thotë se kjo sferë është e rezervuar për burra.

"Diplomacia është sikurse ushtria, një profesion sipas të cilit gratë për shkak të pozitës së tyre specifike s'kanë interesim", ka deklaruar Gashi. Sipas tij, në rast se ndonjë grua emërohet ambasadore, duhet me vete ta marrë edhe familjen.

Qasja kësajsoj e numrit dy të diplomacisë kosovare ilustron më së miri, dominimin mashkullor në sferën e politikës së jashtme. Për këtë shkak edhe qëndrimet e deputetëve të Parlamentit të Kosovës të përmbledhur në një botim shpërfaqin mendimin real për gruan kosovare, thjesht duke e vendosur atë në pozitën e mëkatars, prej së cilës shteti nuk ka dobi.

Madje, një mendim i tillë ironik për gruan nuk haset as në kohërat antike. Teksa kishte parë një grua hipur majë ullirit, Diogjeni kishte thënë: "Sikur të kishin të gjitha pemët të tilla fruta". Ky mendim tanimë është shndërruar në parim në një pjesë të madhe të botës. Përpjekja për të vërë barazinë gjinore është bërë një nga sfidat serioze të pushteteve demokratike në përpjekje për ta përshtatur formulën qeverisëse me gjendjen faktike, sipas së cilës relacioni në numra ndërmjet gjinive është afërsisht i barabartë.

Në këtë kontekst, prijnë në listën e vendeve ku gratë radhiten përkrah burrave në bërjen e politikës Suedia, Holanda, Estonia, Danimarka, Gjermania, Belgjika, Austria etj.

Për më tepër, për ta garantuar përfaqësimin gjinor ekziston edhe Konventa Ndërkombëtare CEDAW, e cila rregullon shumë aspekte të përfaqësimit gjinor. Ndonëse Kosova nuk është ratifikuese e kësaj konvente, për shkak se nuk është anëtare e OKB-së, megjithatë, është përp-



jekur të vërë rregull nëpërmjet ligjeve të harmonizuara me standardet e BE-së. Aktualisht është 30 për qind e Parlamentit të Kosovës që përbëhet nga gratë deputete, por vazhdon të mbetet çështje serioze mospërfshirja e grave në strukturën vendimmarrëse.

Megjithatë, në realitetin kosovar, pjesëmarrja e grave në politikën e jashtme vazhdon të dominohet nga burrat, dhe është larg arritjes së dëshirueshmes. Sipas studimeve të ndryshme, shërbimi i jashtëm ka të bëjë edhe me refleksimin dhe investimin e vet shtetit për fuqizimin e kësaj kategorie të rëndësishme shoqërore.

Politika për gruan - misioni (pa) mundshëm

Në punimin "Perspektiva gjinore në politikën e jashtme të Kosovës", autorja Violeta Kurti-Islami vë re se për gruan karriera nuk ka ambient të përshtatshëm ligjor.


"Në mungesë të veçantë të ligjeve për lejen prindërore / babait ka ndikuar që gruaja të haset në pengesë për të harmonizuar familjen dhe jetën profesionale, prandaj edhe gratë kanë vështirësi në zhvillimin e karrierës së tyre.

Pra në grafikoni 1, është prezantuar struktura aktuale e përfaqësive diplomatike të Kosovës, në të cilën shihet se ka

një dominim të theksuar të burrave në udhëheqjen e misioneve të huaja. Ndërkaq në grafikoni 2, shifrat i nxjerrin misionet diplomatike në Kosovës të shteteve të tjera, kryesisht të udhëhequr nga burrat dhe atë me një shifër prej mbi 85 për qind, kundrejt pak më shumë se 14 për qind që drejtohen nga gratë. Në këtë kontekst, Kosova nuk duket keq nëse bëhet një analogji e tillë, por a duhet të jetë ky modeli që duhet ta ndjekë politika kosovare. Natyrisht se jo,


duke pas parasysh faktin se gruaja kosovare, po bie pre e stereotipeve të krijuara që prej kohësh se politika është vetëm për burra. Një situatë të tillë më së miri e përshkruan në punimin e saj Violeta Kurti-Islami, e cila duke folur për aspekte zakonore të traditës shqiptare e nxjerrë odën si institucion që ka qenë në shërbim të burrave dhe e cila e ka përjashtuar gruan nga prezenca në këtë hapësirë ku krijohet një lloj kulturë e debatit.

Misionet diplomatike të Kosovës jashtë



Misionet diplomatike të Kosovës jashtë

Misionet e huaja në Kosovë



Struktura gjinore e misioneve të huaja në Kosovë

Nga Presidenca

Ikonat e triumfit

Gruaja në Kosovë është bërë simbol i paqes dhe pajtimit, forcë shtytëse e ndryshimeve dhe e zhvillimit në shoqërinë tonë dhe ndërmarrëse e suksesshme në fusha të ndryshme



Atifete Jahjaga

Përpjekjet e shoqërisë kosovare për të arritur barazi gjinore në dekadën e fundit kanë shënuar suksese të pamohueshme. Gruaja kosovare, e cila ka njohur vuajtjet e luftës dhe situatat dramatike të jetës me mungesa të mëdha, ka qenë pjesë qenësore e të gjitha proceseve nëpër të cilat ka kaluar Kosova, që nga periudha e rezistencës e deri te lufta çlirimtare, përfshirë këtu edhe periudhën e tranzitore, rimëkëmbjen morale të pasluftës dhe ruajtjen e familjes dhe të vlerave të saj, por mbi të gjitha të qenit pjesë esenciale e ndërtimit të shtetit demokratik, i cili i ofron mundësi të barabarta secilit qytetar. Me praninë dhe me angazhimin e vet qenësore dhe të qëndrueshëm përgjatë këtyre zhvillimeve që kërkuar shumë sakrificë, Kosova është bërë një vend më i mirë dhe vend që frymon më lirshëm.

Roli i gruas në Kosovë është bere rol prijës në procese të shumta nëpër të cilat po kalon vendi, përfshirë edhe kurajën e saj për të kapërcyer problemet e së kaluarës dhe për të adresuar sfidat e së ardhmes. Gruaja në Kosovë është bërë simbol i paqes dhe pajtimit, forcë shtytëse e ndryshimeve dhe e zhvillimit në shoqërinë tonë dhe ndërmarrëse e suksesshme në fusha të ndryshme.

Pjesëmarrja e gruas kosovare në të gjitha aspektet e jetës publike ka shënuar ngritje viteve të fundit, falë një sërë hapash të ndërmarrë nga institucionet e Kosovës për të zbatuar praktikën më të mira Evropiane dhe për të adoptuar frymën e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, e cila inkurajon dhe promovon pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje. Kjo është bërë edhe përmes kuotave që sigurojnë pjesëmarrjen më aktive të saj në profesionet dhe organizatat që tradicionalisht kanë qenë të rezervuara për meshkuj dhe sidomos përmes përgjegjësisë institucionale në ofrimin e ndihmës dhe përkrahjes shoqërore për to. Si rezultat i gërshetimit të punës së palodhshme të shumë organizatave joqeveritare që e kanë pasur për mision përmirësimin e pozitës së gruas dhe dispozitivave ligjore të parapara dhe në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, në Kosovë tashmë është siguruar një e ardhme më me perspektivë për gruan kosovare.

Ky transformim shoqëror, në bazë të të cilit gruaja po zë vendin që i takon në shoqëri dhe në jetën publike, është reflektuar sidomos në politikëbërje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku gratë përbëjnë mbi 30 për qind të deputetëve, e deri te pjesëmarrja e drejtpërdrejtë vendimarrëse në

kabinetin qeveritar në nivel ministror, në shoqëri civile dhe udhëheqjen e bizneseve të suksesshme. Përpos që zëri i gruas nga këto pozita ka kontribuar dukshëm në krijimin e një baraspeshe dhe politike më të përgjegjshme, krahas mësuesëve të zellshme, mjekeve humaniste dhe gardianeve të sigurisë së përgjithshme që garanton përparimin tonë shoqëror, janë shndërruar në ikona që me mençuri, guxim dhe vendosmëri po krijojnë një të ardhme më ndryshe për gjeneratat e reja.

Këto të arritura historike të shoqërisë kosovare dhe institucioneve në rritjen e nivelit të përfundimit të gruas dhe përmirësimit të përgjithshëm të pozitës së saj, më lejoni që në ditën kur ndihemi krenarë për të arriturat tona dhe festojmë frytet e kësaj pune kolosale, të përkushtohemi rishtas që të bëjmë çdo gjë që është në fuqinë tonë që edhe më tej ta përmirësojmë pozitën e gruas kosovare në shoqëri.

Përkundër të arriturave të prekshme që i ofron realiteti i sotëm, puna jonë dhe përgjegjësia jonë si shoqëri ndaj gruas është larg të qenit e përfunduar. Gruaja në Kosovë vazhdon të jetë në pozitë të vështirë dhe të pafavorshme, e goditur në vazhdimësi nga varfëria dhe dhimbjet e një jete me mungesa të mëdha. Për të përmirësuar gjendjen dhe ngushtuar hapësirën për diskriminimin e saj, ndërmarrjet e deritashme fisnike, por edhe të domosdoshme ligjore duhet patjetër t'i plotësojmë me një shtytje më të madhe për emancipimin dhe arsimimin e gruas kosovare, si e drejtë e pamohueshme njerëzore.

Studimet statistikore të zhvilluara në Kosovë gjatë kësaj dekade dëshmojnë se gruaja kosovare vazhdon të jetë viktimja kryesore gjatë tranzicionit; numri i femrave analfabete vazhdon të jetë 10 për qind më i lartë se i meshkujve të së njëjtës grupmoshë dhe prejardhjes së përafërt socio-ekonomike. Kjo është e padenjë dhe e papranueshme për një shoqëri e cila është përkushtuar t'i ofrojë mundësi të barabarta çdo pjesëtarit të saj. Në këtë fazë, kjo çështje duhet të adresohet dhe të rregullohet me forcën e ligjit, sepse vetëm kështu mund ta përmirësojmë pozitën e gruas kosovare në shekullin 21, këtë epokë të integritimit, të drejtave njerëzore kundër pabarazive dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit.

Si shoqëri duhet ta dimë se përkushtimi ynë për ta bërë gruan të barabartë dhe pjesë të vendimarrjes dhe për ta bërë të fuqishme praninë e saj, arrihet përmes krijimit të politikave të balancuara që garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e çdo qytetari. Pësha dhe përgjegjësia për ta ndryshuar këtë trend dhe për të triumfuar ndaj praktikave diskriminuese të një kohe të shkuar, bie mbi çdonjërin prej nesh na dallim, si në familje po ashtu në jetën publike, e në veçanti bie mbi supet e grave lidere.

Autorja është Presidente e Republikës së Kosovës

Një gjeneratë e re e artisteve dhe sportistëve kosovare është duke e prezantuar shtetin e Kosovës në mënyrë të mrekullueshme - sukseset e tyre janë pjesë e skenave globale, na bëjnë të lumtur, na japin shpresë dhe i tregojnë botës për ne. Ato janë imazhi ynë ideal



Luljeta Vuniqi

Ka disa vite që diskursi rreth përkëqësimit të imazhit të Kosovës, si brenda ashtu edhe jashtë saj, sa vjen e bëhet më i theksuar. Kjo ndodh sidomos në rastet kur publikohen raporte ndërkombëtare, të cilat analizojnë dhe faktojnë çështje nga fusha të ndryshme të jetës në Kosovë, duke ia sjellë kështu në vëmendjen e opinionit publik problemet të cilat e dëmtojnë rëndë imazhin e Kosovës si shtet. Brengosëse janë edhe vërejtjet e shpeshta dhe kërkesat e vazhdueshme të institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë për përmirësimin e imazhit.

Mirëpo, përpjekjet e institucioneve tona për t'u kundërpërgjigjur dhe përmirësuar këtë imazh të dëmtuar janë stihike dhe joproportionale. Ato shpesh përcillen me mungesë të profesionalizimit dhe përkushtimit, që le të kuptohet se nuk merren seriozisht me të. Ndryshe nuk ka si të kuptohen reagimet e liderëve tonë ndaj analizave kritike që janë të pafavorshme për vendin, duke i cilësuar ato si "perceptime", apo në rastin më të keq si "dashakeqësi", respektivisht, "pasojë e dëmtimit të qëllimshëm të imazhit të vendit tonë nga shoqëria civile në Kosovë".

Nevoja për përmirësimin e imazhit të Kosovës potencohet atëherë kur diskutohet tërheqja e investimeve të huaja dhe privatizimi i aseteve publike si PTK dhe KEK, si dhe kur adresohet nevoja e luftimit të korrupsionit dhe zhvillimi i mëtejshëm demokratik, ekonomik, etj.

Një aspekt që nuk zë shumë hapësirë në diskursin publik dhe institucionale sa i përket imazhit të Kosovës është pozita e grave në shoqërinë e Kosovës në përgjithësi, dhe i grave në vendimarrje, në veçanti. Ciniku kujdestar do të thoshte: "Çka po doni më shumë ju gratë, tash e keni një grua Presidente, 30 për qind të grave në Parlament, dy zëvendësryemistres, ministres, etj". Gjithsesi kjo është arritje dhe përparim, ndonëse i kufizuar, siç thuhet edhe në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën për vitin 2011. Këto suksese kanë kontribuar në përmirësimin real të imazhit të Kosovës në rajon dhe botë (mund vetëm të

paramendojmë se çfarë imazhi do të kishim pa to), por ky numër i grave në vendimarrje nuk mjafton që të themi se kemi bërë shumë për përmirësimin e pozitës së grave në Kosovë dhe kështu kemi arritur shkallë të lartë të barazisë gjinore.

Vetë habia e konsiderueshme e kolegeve tona nga rajoni me faktin se Kosova - një vend i vogël, i varfër, dhe me pak traditë demokratike, por me traditë të gjatë patriarkale krahasuar me shumë vende në rajon dhe botë - zgjodhi një grua për Presidente, tregon se ky vend megjithatë ka pësuar ndryshime dhe ka shënuar zhvillime pozitive për sa i përket pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe politike. Por, vështirë se mund t'i bindim, aq më pak t'i impresionojmë, vendet në rajon dhe botë, se gratë në Kosovë janë pjesë përbërëse dhe e barabartë e dinamikave më të rëndësishme në procesin e demokratizimit dhe zhvillimit të brendshëm të vendit.

Formulimi i përmendur shpesh, sipas të cilit, për ta ndërtuar një imazh pozitiv për Kosovën duhet të japim prova se jemi në rrugë të mbarë drejt demokratizimit të vendit, mbetet vetëm një floskulë e cila është bërë një fjalë parazite dhe xhoker për t'u nxjerrë nga pozitë e vështira në retorikën ditore. Për fat të keq, jemi bindur se me fjalë të mëdha e të bukura, të cilat zakonisht e kanë efektin e mjegullimit të realitetit, nuk mund ta inorojmë, apo maskojmë, realitetin, i cili pasqyron deficitin demokratik në shumë fusha të jetës, ku gratë mungojnë dhe janë të padukshme.

Duhet kuptuar se imazhin e Kosovës e dëmton rëndë mungesa e fuqizimit dhe vëmendjes për gratë në pushtetin lokal, në institucionet dhe administratën lokale, asamble, si dhe për gratë në zona të thella të cilat nuk e ndjejnë realisht se janë bërë ndryshime të cilat në mënyrë të përkushtimit e përmirësojnë jetën e tyre.

Përdërisa gratë në Kosovë ende nuk kanë qasje të barabartë në arsim, shërbime dhe përkujdesje kualitative shëndetësore; vazhdojnë të jenë kategoria më e varfër dhe më e papunësuar; janë viktimat më të shpeshta të dhunës në familje dhe trafikimit; nëse gratë e veja të cilat i kanë humbur burrat e tyre në luftë dhe janë kryefamiljare, së bashku me gratë e dhunuara gjatë luftës, ende s'janë kategori juridike dhe nuk njihen nga legjislati aktual - Kosova ende mbetet një vend me shkëlqim të përkohshëm dhe nuk e reflekton gjithë realitetin e tij, i cili duket i zymtë dhe me shumë pak perspektivë, jo vetëm për gratë.

Për imazhin e dëmtuar të Kosovës, përpos institucioneve tona, liderëve aktual dhe atij të kaluar,

përgjegjësi kanë edhe misionet dhe institucionet ndërkombëtare në Kosovë. Ato bartin një pjesë të përgjegjësisë, së paku për faktin se në asnjë rast nuk kanë dhënë shembuj konkretë në institucionet e tyre sesi gratë duhet të jenë pjesë e institucioneve të tyre - jo si numra, por edhe si udhëheqëse dhe vendimarrëse.

Nëse nisemi që nga misioni parë, ai i UNMIK-ut, i cili për shume vite qeverisi Kosovën, e pastaj mbërrimë te i fundit, EULEX-i, me keqardhje konstatohet se nuk pati asnjë grua në krye të këtyre misionëve. Me shembullin e dominimit të burrave në pozitë vendimarrëse të misionëve dhe institucioneve të tyre, ato treguan se edhe në rrafshin global subordinimi i grave është praktikë e zakonshme. Prandaj, krahas kërkesës që Kosova të përkujdeset më shumë për përmirësimin e imazhit, këto misione do të kishin dhënë ndihmë shumë të madhe sikur vetë të shndërroheshin në shembuj pozitivë në këtë aspekt.

Është më se e qartë se institucionet kosovare duhet të merren më seriozisht me përmirësimin e imazhit të Kosovës, duke hartuar strategji dhe politika të cilat janë gjithëpërfshirëse, integruese, me perspektivë të qartë gjinore, si dhe duke i funksionalizuar mekanizmat institucionalë të cilët sigurojnë zbatimin e tyre në praktikë. Jam e sigurt se imazhi i Kosovës do të përmirësohet dukshëm nëse grave do t'u njihet kontributi dhe sakrifica e tyre madhore në krijimin dhe zhvillimin e këtij shteti. Rrjedhimisht, në të ardhmen ato patjetër duhet të jenë pjesëmarrëse kryesore të të gjitha proceseve të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës, jo në rolin e numrave, por si bashkëkrijuese të politikave dhe vendimeve të rëndësishme për vendin. Vetëm kjo do ta mundësonte trajtimin dhe pasqyrimin e tyre korrekt, të denjë, pa paragjykim dhe pa stereotipa.

Imazhi ndërkombëtar i Kosovës do të përmirësohet nëse institucionet dhe shoqëria në të ardhmen do të kujdesen për promovimin dhe mbështetjen e grave artiste si Blerta Zeqiri, Rona Nishliu, Rina Bilurdagu, apo sportistëve si Majlinda Kelmendi, dhe plot grave dhe vajzave të reja me shumë potencial në të gjitha fushat e jetës.

Këto kosovare me forcat e veta i kanë tejkaluar kufijtë kombëtarë, duke e prezantuar shtetin tonë në skenat më të rëndësishme botërore. Sukseset e tyre na bëjnë të lumtur, na japin shpresë dhe i tregojnë botës për ne.

Ato janë imazhi ynë ideal.

(Autorja është drejtoreshë ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore)



VËSHTRIM MBI ASPEKTIN GJINOR TË KOSOVËS: VËSHTRIM MONOGRAFIK (ASHAK, 2011)

Flora, fauna dhe femra

Hasnije Ilazi

Që një kohë mjaftë të gjatë, studioj filozofinë empirike të George Berkeley, dhe vetëm tani, para do kohe, fillova ta kuptoj më ndryshe thënien e tij të famshme "Esse est percipi" (Të jesh, do të thotë të jesh i perceptuar). Shkas për rimeditim mbi filozofinë e Berkeleyt ka qenë botimi i fundit i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës titulluar "Kosova: vështrim monografik" (2011).

Filluar nga filozofia e Berkeleyt perceptimi është një proces mjaftë kompleks për disa arsye: 1. njohja jonë fillon me perceptime dhe është e determinuar nga të njëjtat; 2. ekzistenca e gjërave që perceptohen është e lidhur ngushtë me vetëdijen, respektivisht gjërat ekzistojnë për ata që kanë aftësinë e të perceptuarit dhe 3. vet perceptimi është i determinuar nga natyra e gjërave që perceptohen. Nga kjo del se, mos perceptimi, ose perceptimi i gabuar ndodhë në raste kur aftësia e të perceptuarit, respektivisht vetëdija nuk është në nivel të duhur për të kuptuar ekzistencën, natyrën e gjërave të perceptuara. Paraqitja e gruas, bazuar, pa dyshim, në aftësinë e kufizuar të perceptimit të natyrës së vërtetë të saj, në vështrimin monografik të ASHAK-ut është shembull reprezentativ jo vetëm i një gabimi subjektiv, por edhe i shndërrimit të këtij gabimi në një doktrinë stereotipa të paraqitjes së gruas, të legjitimuar, kësaj here, me mjete "shkencore".

Monografia "burrërore"

Nuk është e rastësishme dhe nuk befason fare se si perceptohet gruaja brenda botimit të ASHAK-ut të titulluar "Kosova: Vështrim Monografik". Nuk është befasi për dy arsye: e para, sepse nuk mund të pritët njohja e shkruar për kontributin e gruas nga një institucion, i cili gjatë tërë historikut të tij ka refuzuar "burrnisiht" të ketë grua në strukturat e tij. Asnjë grua...Për gjatë tridhjeteshtatë viteve... Së dyti, po ashtu nuk duhet habitur për përbërje të monografisë nga aspekti gjinor duke pasur parasysh kryeredaktorët, redaktorët, redaksinë dhe këshillin bashkërendues të monografisë në fjalë. Asnjë grua...

Nga gjashtëdhjetë e gjashtë tituj brenda monografisë vetëm tre tituj janë shkruar nga gratë (madje dy nga tre shkruar janë nga e njëjta autore). Bibliografia e monografisë e përbërë nga 644 tituj, ka gjithsej 22 tituj të autoreve gra, ndërsa nuk përfshinë asnjë studim të mirëfillt të çështjes gjinore (ekziston një numër i konsiderueshëm i hulumtimeve në këtë fushë), në cilëndo fushë të jetës shoqërore në Kosovë.

Kjo bibliografi pastaj, në mënyrë të "denjë" reflektohet brenda faqeve të monografisë, dhe jo vetëm në tekste por edhe në fotografitë e bashkangjiturat. Gratë janë prezente në fotografi vetëm si anonimuse (p.sh "Hasjanja", ose "Femrat debatojnë për pozitën e tyre"), ndërsa fotografitë të cilat tregojnë kontribuuesit e mëdhenj përgjatë historisë dhe në shumë fusha të jetës në Kosovë, dhe kanë pronësi me emër dhe mbiemër, janë pothuajse të gjitha të burrave. Kështu në kapitullin "Arsimi dhe shkencat" është fotografia në të cilën është paraqitur një grup të grave që vijojnë kursin e analfabetizmit. Në të njëjtin kapitull, vetëm disa faqe më tutje dalin fotografitë e prof. Selman Rizas, Akademikut Musa Haxhiu, Ali Hadrit, Esad Mekulit etj. ndërsa në mesin e tyre asnjë fotografi të gruas intelektuale.

Në "Shëndetësi", një nga fusha që (padrejtësisht) konsiderohet fushë më e preferuar dhe njëkohësisht e dominuar (së bashku me arsimin) nga gra, janë fotografitë e Dr. Ali Sokolit, Dr. Xheladin Deda, Osman Imami dhe asnjë Dr. grua. Gratë janë në një fotografi me nëntitull "Shërbime spitalore".

Te "Kultura" e vetmja grua është Mbretëresha në fron, madje edhe ajo pa emër! Njësoj vazhdon edhe në ka-

pitullin e "Gjuhës" dhe të "Letërsisë" ku janë fotografitë e Hivzi Sulejmanit, Din Mehmetit, Enver Gjerçekut, Rrahman Dedajt etj. I vetmi kapitull në të cilin janë edhe fotografitë (me emër dhe mbiemër) të grave është kapitulli "Teatri", ku në mesin e dhjetë fotografive të burrave gjenden edhe dy fotografi të grave: Katarina Josipi dhe Melihate Ajeti. "Kinematografia" nuk ka asnjë! Dhe krejt në fund është edhe fotografia e Nënës Terezë, por së bashku me Gjon Palin e II.

Nga tërë përmbajtja tekstuale e monografisë, e cila si tërësi reflekton dhe vlerëson në mënyrë të jo të barabartë kontributin e gruas dhe burrit, më e pa arsyetueshme është paraqitja e gruas në artikullin e 15. të kapitullit të parë, "Gjeografia".

Artikulli i pesëmbëdhjetë

Nëse për diçka ekziston një konsensus brenda teorive antropologjike, pa marrë parasysh dallime në mes tyre në studimin e esencës së njeriut (kultura, vendbanimi, shoqëria, tradita, puna, gjinia etj.), ai konsiston në atë se njeriu është në rend të parë qenie shoqërore, racionale, dhe çfarë është më e rëndësishme, qenie shumëdimensionale. Tendanca që njeriu të reduktohet në vetëm një dimension (si p.sh. biologjik, racor, etj.) gjatë historisë së njerëzimit ka qenë burim i pashtershëm i konflikteve, luftërave, shkatërrimeve, ndërsa gjatë historisë së gruas ka qenë, bazament i pa lëkundur i pozitës së saj të pabarabartë në shoqëri. Biopolitika përmes të së cilës është nënçmuar pozita shoqërore e gruas potencon dallime në mes burrit dhe gruas, duke u bazuar në cilësitë biologjike dhe duke hiperbolizuar dallimin biologjik,

në favor të mashkullit.

Vet fakti se artikulli 15 quhet "Femra" dhe gjendet brenda kapitullit që quhet "Gjeografia", ndërsa flet për gruan, në mënyrë më të paturpshme përfshin gruan në të njëjtën kategori me florën dhe faunën. Natyrisht, njeriu është edhe qenie natyrore dhe askush nuk tenton të mohojë këtë dimension, të një strukture më të gjerë. Madje identifikimi me natyrën mund të ketë rol pozitiv në ruajtjen e së njëjtës. Por, reduktimi i gruas në biologji, gjë që konfirmohet jo vetëm me emrin e artikullit, por edhe me përmbajtjen e tij, brenda së cilës hapësira më domethënëse jepet rolit reproduktues të gruas, dhe rolit të saj tradicional si nënë dhe amvise, është diçka tërësisht e papranueshme. Aq më pak si dokument zyrtar të një institucioni "elitar" të shkencës, dhe aq më pak kur dihet se ky artikull është shkruar nga një grua "intelektuale".

Brenda të njëjtit artikull përmendet shkurt edhe "pjesëmarrja e femrës në punësim", "përfshirja e femrës në shkollim", "inkuadrimi i femrës në institucionet politike". Paradoksi më i madh që bie në sy është mosnjohja elementare e kuptimit të nocione "femër" dhe "grua", të cilat përdoren vend pa vend, varësisht nga konteksti.

Të jetosh sot në shoqëri moderne, dhe të mos njohësh koncepte bazike të kësaj shoqërie, reflekton një tradicionalizëm intelektual në kuptimin më negativ të fjalës. Ndërsa kur është fjala për dallimin në mes të seksit dhe gjinisë, ai mësohet edhe në lëndën e edukatës qytetare në shkollat fillore: seksi (F/M) paraqet dallimin biologjik në mes të femrës dhe mashkullit (i cili nuk karakterizon vetëm llojin njerëzor por, edhe botën shtazore), ndërsa gjinia është koncept shoqëror, i cili më

tepër ka të bëjë me rolet shoqërore që i imponohen grave dhe burrave brenda kontekstit shoqëror. Prandaj kur flitet për shkollim, punësim, politikë mendohet në role shoqërore të grave dhe burrave brenda fushave të ndryshme të jetës shoqërore. Dhe, prandaj është paradoksale se si këto nocione mund të vendosen brenda kapitullit "Gjeografia", e jo brenda kapitujve "Arsimi", "Kultura" "Ekonomia", respektivisht brenda kategorive përkatëse shoqërore.

Artikulli 15 po ashtu, në mënyrë reprezentative ilustron bibliografinë e mangët dhe jo adekuate të përdorur nga autorja, e cila është kufizuar ekskluzivisht në librat e shkruara nga ana e saj, e që ofrojnë një perspektivë të kufizuar të çështjes së gruas. Por, artikulli reflekton edhe problemin thelbësor që ka të bëjë me çështjen në fjalë: mos mundësinë e distancimit të vet gruas nga ndikimi socio-kulturor të një shoqërie ende tradicionale, e cila karakterizohet nga mënyra stereotipa e të menduarit mbi pozitën e gruas. Si rezultat të kësaj mbesin të pa trajtuara çështjet shumë esenciale: paraqitja e gruas në media, gruaja dhe burime ekonomike, çështja e trashëgimisë, gruaja dhe pushteti etj.

Në librin "Kur qau Niçja", thuhet se interpretuesit e çështjeve "kurrë nuk janë të ndershëm, jo me qëllim, sigurisht" pasi që "nuk mund të dalin nga korniza e tyre historike. Dhe as nga korniza e tyre autobiografike". Por kjo nuk mjafton si arsytim në botën akademike!

(Mos) Njohja e kontributit

Duke u nisur nga parimi bazë të një shoqërie demokratike, e që është drejtësia, çdo lloj pabarazie dhe diskri-

minimi është një hap më larg vlerave, zhvillimit dhe progresit. Nëse demokracia liberale deri më sot nuk ka gjetur zgjidhje të plotë për çështjen gjinore, duke pasur parasysh pozitën e pafavorshme të gruas në sferën private të jetës, sfera publike ofron garanci ligjore dhe politika publike të cilat sigurojnë pozitën e barabartë të gruas dhe burrit në shoqëri. Pse atëherë, asnjëherë deri më tani, dhe pothuajse në asnjë shoqëri nuk ka ndodhë barazia gjinore? Përgjigja është, sepse asnjë sistem, nuk ka krijuar mekanizmat adekuat për të njohur, në mënyrë të barabartë, kontributin e secilit anëtarë të shoqërisë.

Institucione, në veçanti ato që kanë për mision udhëheqjen e ndryshimeve në drejtim të progresit të përgjithshëm shoqëror, duhet të kenë për qëllim pikërisht njohjen e kontributit dhe vlerës të secilit individ, përmes së cilës njohje, në mënyrë të natyrshme do të përfshihen individët në hierarkinë shoqërore.

Zhvillimi i përgjithshëm shoqëror nuk matet vetëm përmes ekonomisë, bujqësisë, fondit pensional, dhe sigurimit shëndetësor, por përmes të përfshirjes së barabartë të dy gjinive në krijimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e të mirave të përgjithshme shoqërore. Nëse kthehemi edhe një herë në fillim të tekstit, do të kuptojmë se sa ndikim domethënës në këtë drejtim ka mënyra se si paraqiten, respektivisht perceptohen rolet gjinore brenda shoqërisë.

Ndërsa roli i gruas intelektuale është i pazëvendësueshëm. Sepse "përgjegjësia jonë ndaj jetës është që të krijojmë më të lartën, jo të riprodhojmë më të ulëtën." (Kur qau Niçja, faqe 215)



Çfarë thonë gratë nga politika dhe shoqëria civile për të arriturat dhe ngecjet, gjatë vitit 2011



**Edita Tahiri -
zv. kryeministre**

Gratë kanë bërë më shumë për shtetin dhe shoqërinë sesa këta të fundit për gratë

Roli i grave në ndërtimin e shtetit dhe të demokracisë ka shënuar përparime të konsiderueshme, por mbeten edhe shumë punë për tu bërë. Edhe gjatë vitit 2011, gratë kanë bërë më shumë për shtetin dhe shoqërinë se sa këta të fundit për gratë. Duhet gjetur rrugët për një përkrahje të ndërsjellë.

Mendoj se duhet të krijojmë një paradigme të re për fuqizimin e grave në Kosovë duke investuar në leadershipin e gruas dhe sigurimin e kushteve adekuata për këtë qëllim. Shteti dhe politika duhet të udhëhiqen nga të dy gjinitë në mënyrë të natyrshme siç është krijuar edhe vet njerëzimi.

**Mimoza Kusari Lila -
zv.kryeministre**



Në aspektin femëror ndihemi të privileguara që kreun e shtetit e kemi një grua

Viti 2011 mund ta konsiderojmë si një vit i cili i ka krijuar një hapësirë më të madhe rolit të gruas në vendimarrje. Në aspektin femëror ndihemi të privileguar që kreun e shtetit e kemi një grua, çfarë na bën shtetin e parë në rajon me një grua në këtë pozitë. Po kështu konsiderojmë se gratë në Kosovë, kryesisht ato në politikë, janë pjesë e proceseve shumë të rëndësishme për Kosovën si lëvizja e lirë e mallrave, qytetarëve si dhe proceseve integruese drejt Bashkimit Evropian. Natyrisht që në këto aspekte mbetet ende shumë punë për t'u bërë dhe finalizimi i tyre do të ishte një fitore e madhe e punës, përkushtimit të gruas, e cila ka rolin kyç në avancimin e tyre. Pavarësisht faktit që në vitin 2011 është zburur në një farë mënyre raporti në udhëheqjen e institucioneve të rëndësishme nga gratë, jemi të vetëdijshëm që në fushën e të drejtave të grave nuk është bërë mjaftueshëm. Na nevojitet një përfaqësim më i madh në të gjitha fushat e aktiviteteve tona: politikë, ekonomi, shëndetësi, sistemin juridik etj. Po kështu na nevojitet një punë më e madhe sa i përket parandalimit të dhunës dhe diskriminimit ndaj grave. Shpresojmë që në vitin 2012 të kemi një bashkëpunim edhe më të

frytshëm të të gjitha institucioneve në vend qoftë shtetërore ashtu edhe private, në përmirësimin e rolit të gruas në shoqërinë tonë.

**Vlora Çitaku - ministre e
Integrimeve Evropiane**



Gratë nuk duhen përjashtuar nga proceset e rëndësishme

Padyshim që viti 2011 do hyjë në kujtesën tonë kolektive si viti kur bashkërisht zgjodhëm Presidenten e parë grua në Kosovë. Megjithatë, me fare pak përjashtime, gratë në Kosovë ndonëse është e përfaqësuar, fuqia e sajë vendimmarrëse nuk është e mjaftueshme.

Për tu bërë anëtare të BE-së, Kosova duhet të ndërmarrë shumë reforma dhe të tejkaloj shumë sfida. E këto mund të bëhen me shpejtë e më lehtë nëse angazhohim tërë potencialin tonë njerëzor, e assesi duke e përjashtuar nga proceset e rëndësishme gruan.

Igballe Rogova - aktiviste



Nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës

Me gjithë faktin që në gjithë botën, por edhe në Kosovë, sot e kësaj dite gratë dalin në rrugë dhe kërkojnë të drejtat e tyre, akoma shumë njerëz e shohin këtë ditë feste për të uruar nënat, motrat, bashkëshortet e tyre, thujse gratë gëzojnë të drejtat e tyre.

Edhe 100 vjet mbas ditës kur për herë të parë, gratë dolën në rrugë për të kërkuar të drejtat e tyre, akoma ato nuk i gëzojnë këto të drejta.

Tash disa vjet Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, më 8 Mars, del në rrugë për të kërkuar të drejtat e grave. Çdo vjet, merret një çështje për avokim. Vitin e kaluar ngritëm zërin për të drejtat në fushën e shëndetësisë. Sivjet, u menduam gjatë se për cilën çështje të ngrihet zërin tonë në rrugë, sepse ka shumë çështje që na shqetësojnë sot e kësaj dite.

Nëse shikojmë konceptin e sigurisë njerëzore, na bëhet e qartë se ende ka shumë çështje që kontribuojnë në pasigurinë e popullatës së Kosovës, megjithëse ka kaluar më shumë se një dekadë nga fundi i luftës.

Nënat dhe familjet e personave të pagjetur që nga lufta, edhe trembëdhjetë vite më pas, ende nuk ndihen të sigurta nga aspekti ekonomik, shoqëror apo emocional ngase familjarët e tyre mbesin të pagjetur; shteti dhe institucionet ndërkombëtare kanë ndërmarrë pak hapa për të adresuar këtë çështje përkundër

protestave dhe grevave të urisë që nënat shpesh i organizojnë;

Edhe përkundër interesimit fillestar të mediave mbi çështjen e dhunimeve të grave gjatë luftës, ato nuk kanë gëzuar mbrojtje adekuata dhe nuk kanë parë drejtësi për atë që u ka ndodhur. Miratimi i Rezolutave 1325, 1820 dhe së fundmi 1888 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nuk është përcjellë me zhvillimin e programeve afatgjata të cilat do t'u garantonin grava siguri, fizike dhe emocionale, pas pësimit nga ushtrimi i dhunës apo gjatë procedurave gjyqësore. Gratë e dhunuara ende nuk kanë marrë drejtësinë e merituar dhe ndërkohë presin mbështetje nga institucionet qeveritare dhe shoqëria civile në Kosovë.

Kjo e fundit është çështja për të cilën Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës do të ngrëjë zërin, duke organizuar protestë, me moton: "Nuk duam lule por duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës".

Përmes kësaj proteste ne dëshirojmë të përkrahim moralisht gratë e dhunuara gjatë luftës; tu themi publikisht se ato nuk kanë faj për atë që ju ka ndodhë por kanë faj institucionet që i kanë harru gjithë këto vite; kanë faj qytetarët që i kanë nënçmuar dhe kanë bërë me gisht. Po ashtu kërkojmë mbrojtje ligjore për to.

Ua kemi borxh.

Veprora Shehu - aktiviste



Mospërballja me të kaluarën pengon drejtësinë tranzicionale të grave në Kosovë

Pas 13 vitesh të përfundimit të luftës në Kosovë trauma psikologjike dhe gjurmët fizike të dhunës kanë ngelur akoma të freskëta. Përballja me të kaluarën, përndjekja e krimeve të luftës, rehabilitimi psiko-social dhe institucional i viktimave e mbi të gjitha kërkim falja dhe njohja publike e dhimbjeve të këtyre grave janë aspektet kryesore të arritjes së drejtësisë tranzicionale në vendet e pas luftës.

Por sa janë prekur këto elemente të drejtësisë gjatë periudhës së tranzicionit në Kosovë? Përdërisa rehabilitimi psiko-social i femrave të traumatizuara nga lufta është ofruar vetëm nga OJQ-të e grave, për denoncimin e këtyre krimeve sa që bëhet fjalë. Dosjet e krimeve seksuale kanë ngelur të mbyllura në sirtarët e këshillimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe OJQ-të që merren me përkrahjen e këtyre grave për shkak të heshtjes së kimit si nga ana e këtyre grave por edhe injorimit të institucioneve për tu marrë me këtë temë.

U dëshën 12 vite pas luftës që për herë të parë dhuna seksuale ndaj grave në Kosovë të përmendët në Parlamentin e Kosovës pa ndonjë plan të veprimit të përkujdesjes ndaj këtyre grave. Përdërisa gratë e abuzuara gjatë luftës në Bosnjë trajtohen si viktimat e luftës duke u integruar në Ligjin për Viktima Civile të Luftës që u ofron mirëqenie sociale dhe beneficione në të gjithë sektorët institucionel, gratë në Kosovë, vazhdojnë të përballen me ndjenjën e turpërimit dhe kushte të rënda sociale.

Mungesa e arritjes së drejtësisë tranzicionale për viktimat e luftës i

përkrahur mungesës së vullnetit politik për tu përballur me të kaluarën dhe implementuar reforma institucionale si përgjigje e shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut në të kaluarën dhe parandalimin e përsëritjes së këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Nevojitet një mobilizim i institucioneve dhe shoqërisë civile që të ndërprit praktikën e mosndëshkimit, e mbi të gjitha mobilizim i vet viktimave që të thejnë heshtjen dhe të dokumentojnë krimet e përfutur.

Sevdije Ahmeti - aktiviste



Problemi më i madh për gruan kosovare është vartësia

Nuk mendoj se viti 2011 do të mund të veçohej si ndonjë vit i veçantë sa i përket fushës së të drejtave të grave në Kosovë. Edhe viti që shkoi përshkohet me ngecje e përparime në këtë aspekt. Të drejtat njerëzore të gruas janë siguruar përmes mekanizmeve, filluar nga Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, ligjet të tjera nga të cilat mund të shkoqiten format e realizimit të të drejtave njerëzore. Është individit ai që siguron se këto të drejta mund ose nuk mund të realizohen. Pra, institucionalisht të drejtat janë të realizueshme edhe me Rezolutën 1325 të KS të KB bashkë me rezolutat që pasuan ju është krijuar hapësira e bërjes realitet në Kosovë. Këto janë të arriturat. Ka mbetur përkthimi e këtyre mekanizmeve në jetën normale për gruan, e që e gjithë kjo varet nga vullneti individual.

Ngecja, sipas mendimit tim është në mungesën e artikullimit të përparësisë së kërkesave dhe të bashkimit për realizimin e tyre.

Gratë edhe më tutje vazhduan të ngelin të shkapërdërdhura dhe të qara në gratë e administratës, gratë institucionale, të lëvizjeve civile dhe në ato që nuk dinë kah t'ia mbajnë. Secili grup ruan pashallëkun e vet, edhe pse gratë e lëvizjeve civile janë treguar më solidare dhe më luftarake në nxitjen dhe zgjidhjen e disa problemeve. Brengos fakti se punën që nisnin gratë, pra misionin që kanë para e lënë në gjysmë, solidariteti bëhet më shumë retorikë se realitet.

Problemi më i madh për gruan është vartësia. Ka ardhur koha kur duhet menduar se ne gratë duhet të shkurozohemi nga interesi individual vetëm e vetëm që të arrijmë synimet për të drejtat tona, nga të cilat do të përfitojmë të gjithë.

Donika Kada - deputete



Barazia mund të arrihet atëherë kur të arrijmë barazinë ekonomike

Do dëshiroja që të arriturat në fushën e avancimit të drejtave të gruas të mund të numëroheshin çdo vit apo të kemi rezultate sinjifikative në baza vjetore. Por fatkeqësisht nga përvoja e dimë që rezultatet konkrete arrihen shumë ngadalë hap pas hapi pas përpjekjeve shpeshherë mbinjerëzore shohim lëvizje të vogla pozitive. Kështu ndodhi edhe në vitin 2011, u bë shumë punë mirëpo rezultatet edhe më tutje janë modeste. Një e arritur gjatë këtij viti është padyshim zgjedhja e gruas së parë Presidente e Kosovës që vendin e portretizoi si shembull në Rajon, kjo u përcoll edhe me fuqizim dhe bashkëpunim të grave në politikë. Ndërsa ngecjet me të mëdha vazhdojnë të lidhen me aspektet ekonomike të gruas kë ende ka shumë pabarazi. Vazhdoi të konsideroi që barazia mund të arrihet atëherë kur të arrijmë barazi ekonomike ndërmjet grave dhe burrave.

Valbona Salihu - aktiviste



Sundimi i ligjit është një nga sfidat më të rëndësishme të shoqërisë kosovare

Kosova ka një kornizë ligjore të konsoliduar sa i përket garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grave, duke filluar nga Kushtetuta, e cila i përmban parimet e përgjithshme të barazisë dhe mos diskriminimit.

Shumica e ligjeve përmbajnë dispozita të veçanta që i referohen barazisë gjinore. Komponenti kryesor përberës i kësaj kornize është, pa dyshim, Ligji mbi Barazinë Gjinore.

Sundimi i ligjit është një nga sfidat më të rëndësishme të shoqërisë kosovare e posaçërisht i ligjeve me të cilat garantohet barazia gjinore. Me gjithë garantimin e barazisë gjinore me dispozita ligjore, niveli i zbatimit të tyre është i pakënaqshëm.

Në Kosovë femrat "de jure" janë të barabarta para ligjit, por "de facto" një numër i madh prej tyre ende janë të diskriminuara. Kjo shihet në praktikën që zbatohen në shoqërinë tonë lidhur me masën trashëgimore, e cila nuk ndahet ashtu siç përcaktohet me ligj, sepse gruaja, në të shumtën e rasteve, nuk e realizon këtë të drejtë; për më tepër, as pasuria e krijuar gjatë martesës nuk evidencohet si pronë e përbashkët e bashkëshortëve, ashtu siç e parashikon ligji.

Sakibe Doli - aktiviste



U promovua Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës

Viti 2011 solli themelimin dhe promovimin e Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës dhe Programin e Kosovës kundër dhunës në familje.

Por këtu nuk përfundon çdo gjë. Këtu duhet të filloje jetësimi i dokumenteve si të obligueshme për periudhat e ardhshme me të cilat burrat e qytetarët do të jetojnë të lirë dhe të barabartë. 8 Marsi është dita kur duhet të reflektojmë për të këto të arritura por edhe për të ngritur zërin për ndryshime.

Lumnije Hashani - ekonomiste



Gratë janë më pak pranishme në fushën e biznesit

Në Kosovë ekzistojnë parakushtet themelore/baza juridike që promovon barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës e me theks të veçantë në ekonomi. Shikuar në praktikë, gratë janë më pak të pranishme në fushën e biznesit për arsye se ballafaqohen me disa sfida më të mëdha krahasuar me burrat një ndër to është edhe "pafuqia" për investime për arsye të barrierave që shfaqen gjatë marrjes së kredive në banka. Gruas i mungon akses i ndaj kredisë kaq i domosdoshëm për mundësimin e barabartë të saj në burimet financiare. Kjo sigurisht ndodhë për shkak të zvarritjeve të operacioneve bankare, garancisë së pronësisë, praktikave të gabuara të ndjekura shpesh në regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, konkurrencës së ashpër dhe të pabarabartë etj. Edhe përkundër këtyre sfidave që paraqiten në praktikë, jemi dëshmitarë se në raste të caktuara gratë mund të jenë të suksesshme në biznes falë vendosmërisë së tyre për të arritur progres, ndihmës dhe përkrahjes së institucioneve qeveritare përmes subvencionimit sidomos në sferën e bujqësisë. Po ashtu janë aktive edhe disa OJQ që ofrojnë programe për aftësim profesional dhe ndihmë të drejtpërdrejtë.

Albulena Haxhiu, deputete



Shumë pak progres sa i përket avancimit të të drejtave të grave në Kosovë

Ashtu si edhe vitet që lamë pas dhe jo vetëm 2011 mund të themi është shënuar shumë pak progres sa i përket avancimit të të drejtave të grave. Meqë të drejtat e gruas si të drejta elementare e të patjetërsueshme janë në një stad të rifillimit të shkuarjes apo rishkuarjes së mekanizmave ligjor dhe ratifikimit

të shumë rezolutave e rregulloreve ndërkombe të. Si për çdo shtet ashtu edhe për Kosovën janë obligative dhe në bazë të këtyre obligimeve duhet nxjerr politika avancimi që siguron dhe mbron të drejtat e grave. Përveç tjerash janë edhe dy probleme të drejtpërdrejta që atakojnë gruan në Kosovë ajo e trafikimit me qenie njerëzore dhe dhuna në familje. Raporte të ndryshme vendore e ndërkombëtare shprehin shqetësimin për këto probleme të shoqërisë dhe fatkeqësisht kemi rritje statistikash dhe aksesit zvogëlim të tyre. Mbetet sfida implementim i të gjithë mekanizmave ligjor të vendit e që kanë për fokus, parandalimin, mbrojtjen dhe avancimin e roleve gjinore.

Flora Macula - aktiviste



Pjesëmarrja e gruas në politikë dhe vendimmarrje është reflektim i pozitës së tyre në partitë politike

Përfaqësimi i grave në vendimmarrje sigurohet me kuotë për vite të tëra, ky veprim afirmativë filloi të jap rezultate, në vitet e fundit së paku në nivelin qendror. Në vitin 2011 numri i grave në poste kyçe në nivelin qendror u rrit. Ndikimi i kësaj iniciative është i rëndësishëm si në vend ashtu edhe në rajon dhe botë. Së pari zgjedhja e një gruaje si Presidente të Kosovës përmirëson imazhin e vendit tonë në tërë botën, zhduk paragjykimet për shoqërinë kosovare që ndikon në politikën e jashtme pozitivisht, e njëkohësisht sensibilizon audiencën kosovare në aspektin e përfaqësimit gjinor

Iniciativa tjetër që një grua të udhëheq bisedimet teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është për t'u përhëndetur, sidomos përzgjedhja e një gruaje me një bagazh të madh në politikë dhe diplomaci, e cila njëherit është edhe zëvendëskryeminstre. Për më tepër kemi edhe një zëvendëskryeminstre, që njëherësh drejton ministrinë e tregtisë dhe industrisë, e cila ishte mjaft e vendosur në hapat që i ndërmori në lidhje me masat e reciprocitetit. Së fundi procesi i integritetit në BE drejtohet nga një ministere dhe shpresojmë se angazhimi i saj do rezultojë pozitivisht në të ardhmen e afërt të Kosovës.

Mirëpo pa marrë parasysh këtyre arritjeve ende vazhdojnë të jenë të ulëta treguesit e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje, sidomos kur flasim për nivelin lokal/komunal. Pjesëmarrja e gruas në politikë dhe vendimmarrje është reflektim i pozitës së tyre në partitë politike, të cilat përsëri duhet thënë se janë domene burrash dhe ka padyshim ndikim negativ dhe përcaktues për afirmimin e gruas në politikë dhe vendimmarrje, pasi partitë janë qendrat ku bëhen politikat e angazhimit dhe ndarjes së përgjegjësisë.

Duhet rikujtuar se institucionet qeveritare janë përgjegjësit kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e kanë obligim që të sigurojnë çdo gruaje dhe burri jetë kualitative pa dhunë, kërcënime dhe të krijojnë mundësi të barabarta për të gjithë. Institucionet e Kosovës kanë mundësi të bëjnë aleat shoqërinë civile/organizatat e grave, duke e ndihmuar punën e tyre të palodhshme drejtë barazisë gjinore dhe të drejtave njerëzore të grave.

INTERVISTË E MINISTRIT TË DREJTËSISË, HAJREDIN KUÇI

Kuçi inkurajon gratë që të punojnë në drejtësi

I pari i drejtësisë në vend fton gratë në Kosovë që të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe të mos i frikësohen punës në këtë segment. Pavarësisht nga e kaluara, Kuçi thotë se tashmë ekzistojnë ligje, të cilat kanë kontribuar në avancimin e gjinisë femërore në pjesëmarrje e vendimmarrje

Pavarësisht nga e kaluara kur njerëzit në përgjithësi e gratë më veçanti kanë përtuar të punojnë në sistemin e drejtësisë duke e cilësuar atë si punë për të tjerët, zëvendëskryeministri njëherazi ministri i Drejtësisë së Kosovës, Hajredin Kuçi inkurajon gratë që të jenë pjesë e këtij sistemi madje thotë se për arsye të ndryshme ato janë më të drejta në marrjen e vendimeve.

"E para, gratë janë më pak të ndikuara nga ambienti kulturor dhe politik dhe e dyta në vendimmarrje janë më të ndjeshme në kuptimin pozitiv pra vijmë tek një vendim më i drejtë. Ajo që mund të them është se sistemi i drejtësisë nuk reflekton negativitet në raport me barazinë gjinore. Përkundrazi ka një pozitivitet dhe ka një ambient proporcional jo ndoshta qind për qind ashtu siç duhet por jashtëzakonisht të prezantuar", thotë ministri Kuçi

Ai thotë se nuk kanë të dhëna të sakta se cili është përfaqësimi gjinor nëpër institucionet e drejtësisë duke përfshirë edhe administratën e MD-së, gjykatat e prokuroritë por thotë se janë munduar që të kenë një përfaqësim adekuat. Ai shton se nuk kanë punësuar në punë gra vetëm sa për sy e faqe, që vetëm të jenë pjesë e ndonjë institucioni, por shton se të punësuarat nëpër këto institucione, japin këshilla e bëjnë punë në shërbim të vendit.

"Në menaxhimin e MD-së, në përbërjen e kabineteve së MD, por edhe në sistemin në tërësi kemi qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm që të bëjmë një prezantim të tillë. Nëse marrim po ashtu përbërjen e gjyqësorit apo të prokuroritë, do të marr shembull vetëm gjykatën Supreme në të cilën ka më shumë të gjinisë femërore sesa mashkullore", thotë Kuçi.

Edhe në gjykatat e niveleve tjera ai ka besim të plotë në përfaqësimin adekuat por thotë se kulmi për të parë shembullin e përfaqësimit gjinor, është gjykata Supreme.

Ai inkurajon gratë që të jenë më të përkushtuara, më të angazhuara dhe mbi të gjitha t'i besojnë pjesëmarrjes në drejtësi.

"Drejtësia nuk është punë e rëndë për askënd dhe në veçanti mbi të gjitha drejtësia nuk është punë e cila nuk bën me u marrë me të. Përkundrazi është punë e cila i stimulon njerëzit të merren. Gratë madje mund ta ushtrojnë më shumë drejt, pa ndikime të ambientit kulturor, politik apo të tjerat ku jetojmë dhe me një sensitivitet për vendimet", vlerëson i pari i drejtësisë në vend.

Për 8 Mars, festë për gratë e dënuara

Ministri Hajredin Kuçi thotë se përfaqësimin e gjinisë femërore është munduar që ta paraqes qysh nga kabineti i tij prej ministri duke angazhuar kështu përveç asistentëve, jo të gjitha femra, edhe këshilltare të cilat sipas ministri bëjnë punë të shkëlqyeshme. "Jam munduar që edhe në përfaqësim të niveleve të larta, po e marrim shembull shërbimi sprovues udhëhiqet nga një femër pastaj kemi në pozita të drejtorëve apo zëvendësdrejtorëve të gjinisë femërore, të shërbimit korrektues dhe në pranimin në punë unë e kam respektuar në vazhdimësi atë dhe gjinia femërore ka pasur përparësi", thotë Kuçi.

Bashkë me stafin e tij sikurse vitin



e kaluar por edhe këtë vit, ministri Hajredin Kuçi pritet që ditën Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsin ta kalojë e të festoj me nënat, gratë e gratë që janë duke vuajtur dënimin për arsye të ndryshme.

"Unë them se ato kanë obligime ligjore por edhe ne kemi obligim që t'i respektojmë liritë dhe të drejtat e tyre dhe për këtë, për një moment ato ta ndiejnë vetëm si nëna, si femra, si gra apo diçka tjetër të barabarta në shoqërinë tonë. Do ta bëj të njëjtën gjë edhe këtë vit dhe kam tentuar që ato ta ndiejnë vetëm edhe me angazhim në punë, me kujdes, me kushte të veçanta dhe unë besoj që kushtet janë të përafërta me sistemet perëndimore por që ia ruajnë intimitetin dhe cilësinë e saj edhe si femër", thotë Kuçi.

Ndonëse me ardhjen e tij prej ministri, Kuçi ka bërë ndarjen e administratës dhe nuk ka kompetencë që të përzihet në atë të prokurorisë e gjykatave, ministri beson se përfaqësimi gjinor është në nivel të duhur por thotë se administrata e MD-së është shembulli më i mirë është për të tjerët

"Në administratën tonë, ne kemi krijuar ambient dhe unë po them shembulli më i mirë është kur punonjësit e MD-së e shohin ministrin që ka këshilltare gra, të cilat jo vetëm që janë sa për sy e faqe, bile mund të them se janë në një ambient shumë të barabartë e bile ndoshta të privileguara në kuptimin pozitiv por gjithnjë si rezultat i kapaciteteve të tyre", thotë Kuçi.

Kriten ndëshkimet e ngacmimeve seksuale

Në kuadër të punës që ka bërë MD-ja në përmirësimin e infrastrukturës ligjore për mosdiskriminim të gjinisë femërore e në çështjet e përafërta me të, Hajredin Kuçi përmend Kodin e ri Penal, i cili sipas tij ka rritur politikën ndëshkimore për kryesit e këtyre veprave penale.

"Në Kodin e ri penal e kemi bërë një avancim që femrat të cilat janë viktimat të trafikimit, mund dhe nëse bashkëpunojnë me prokurorinë, nuk do të jenë pjesë e inkriminimit. Ka qenë më herët mundësia që të jenë pjesë e inkriminimit. Plus

Femrat të drejtë në pronë

Duke u bazuar nga e kaluara, ministri i drejtësisë thotë se çështje të ndryshme pronësore janë zgjedhur vetëm brenda për brenda familjes dhe si rezultat shumicën e herëve, gratë nuk kanë kërkuar të drejtë në pronë. Ligji për Trashëgimi, i miratuar së fundi, sipas ministrit Kuçi e rregullon një çështje të tillë dhe asnjë ndarje e pronës nuk mund të bëhet në shtëpi por duhet të bëhet në gjykatë.

"Tash nuk shkon si më herët kur pala këto çështje të zgjidh në shtëpi, tani duhet përmes gjyqit. Kjo do të thotë se derisa shkon në gjyq do të mendon më shumë dhe kjo është avancim", thotë Kuçi.

QYTETI PA DASHURI

652 burrat dhe 20 gratë e Prishtinës

Gruaja kosovare është nxjerrë nga historia dhunshëm duke e tërhequr për flokësh, për ta përligjur imoralitetin dhe agresionin e (pu)shtetit mashkullor. Në traditën kosovare është instaluar një moral fals dhe i dyfishtë, për ta justifikuar diskriminimin e shpesh edhe dhunën fizike ndaj gruas, duke u bazuar herë në norma kanunore (tribale) e herë në parime fetare, por shpesh edhe në postulate patriotike?



Halil Matoshi

Gjithnjë më ka impresionuar shenjëzimi i rrugëve me numra e jo emra njerëzish realë, sidomos jo të politikanëve dhe asnjëherë nuk më kanë impresionuar emrat e heronjve dhe monumentet mesjetare me kuaj, shtiza e shyta, me shpata e kurora mbi krye.

Gjithnjë dhe gjithandë pos në gjeografinë shqiptare më kanë impresionuar gratë e fuqishme nëpër histori si dhe monumentet e tyre.

Kosovarët vazhdojnë të jenë robër të historisë dhe miteve, nga të cilat burojnë edhe tabu që janë kodifikuar në Kanunin e Maleve, por edhe aso fetare, fetishe për gratë, të shtresëzuara me rrënjë të thella në traditën shqiptare. Sipas Dr. Nicola Mai, këto tabu çojnë në një rend simbolik fallocentrik dhe heteropatriarkal në të cilin, po t'i referohemi Lacanit nuk ekzistojnë dy seks, por një i vetëm: Njeri dhe Tërë rreth tij. Sipas këtij rendi autoritar dhe homogjen, vetëm burrat e vërtetë, apo sikurse thotë Herzfeld, vetëm burrat që "dinë të tregohen burra", janë ruajtësit dhe mbajtësit e nderit dhe respektit dhe vetëm ata kanë të drejtën të administrojnë pushtetin duke afirmuar mbizotërimin dhe dominimin e tyre mbi "të tjerë" me më pak nder dhe kryesisht jopatriotik, pra me më pak mashkullorit, sipas mendësisë tipike shqiptare: "Po vjen një njeri me një grue!", dhe nëse "ajo" është e fuqishme, këto tipare nuk i ka të seksit femëror, por veti të panatyrshme!?

Pra, gruaja në traditën shqiptare kanunore zihet "rob" dhe kur ajo shfaqë cilësi jo të rëndomta femërore, shndërrohet në "grue burmeshe"!


Studiuesi Mai vlerëson se gruaja shqiptare (por edhe grupet tjera margjinale shoqërore) meqë nuk u përgjigjet këtyre standardeve normative të mashkullorizuar dhe hegejmonizuar me respektueshmëri dhe nder, ndajnë funksionet e përbërësve tjerë, duke i shërbyer kësaj, nëpërmjet ndërveprimeve socio-kulturale, dallimit të subjekteve të privilegjuar hegejmonë.

"Pozicioni i tyre në fushën diskursive është ai i nënshtrimit të heshtur dhe të pafuqishëm ndaj subjektit fallocentrik, mashkullor që sundon skenën simbolike dhe po ashtu edhe peizazhin socio-kulturor shqiptar", thotë Mai.

Në anën tjetër Michel Foucault të "Vullneti për dije" mendon se pushteti e detyron në mosekzistencë seksin.

"Pushteti vepron duke shpallur rregullën: Sundimi i pushtetit mbi seksin sigurohet përmes gjuhës, ose më saktë nëpërmjet aktit gjuhësor i cili, duke qenë se artikulet dhe thjesht nga fakti i artikullimit, prodhon gjendje ligjore."

Pushteti flet, thotë Foucault, dhe fjala vlen si rregull. Kësaj, forma e kulluar e pushtetit mishërohet te funksioni i legjislatorit dhe, në lidhje me seksin, mënyra e tij e veprimit është e tipit juridiko-ligjor. Kjo logjikë pushteti mbi seksin, sipas këtij autori, së këndejmi shfaqet si logjika paradoksale e një ligji të trefishtë: detyrim në mosekzistencë, mosshfaqje (mbulim) dhe heshtje. Në këtë kontekst, vitin e kaluar në një pllakat në Prishtinë u mbulua me fashë të bardhë gjiri i një nëne, nga një fotografi e "The Times" që ishte shndërruar në ikonë të përbotsme të vuajtjes së civilëve kosovarë gjatë



përndjekjes nga fashizmi serb.

Para do kohësh shkrova për një fletore shënimesh që u ishte shpërndarë deputetëve në Kuvendin e Kosovës ku shqueshin disa proverba tradicionale që fyerin gruan si qenie jo e denjë për pushtet, madje as në fushën e dijës.

Dhe njëri nga komentuesit mashkullor me cinizëm më shkruante: "I paskan fyer gratë, e ani pse je prekur ti?"

Ky është vendi që burri nuk është vetëm Zot, Profet dhe Pushtet, por edhe ai që vlerëson burrërinë edhe të burrave tjerë, që janë ose mendojnë ndryshe, njëjtë sikur ai vendos për nderin dhe "burrërinë" e gruas, sepse tiparet si trimëria, atdhetaria, mençuria, guximi etj, janë ekskluzivisht në pronësi të mashkullorit.

Në Evropën Perëndimore dominojnë emrat e rrugëve që janë shkruar të mos ketë Prishtinë dhe emërtimi i shesheve dhe rrugëve sipas grave të zonja por të brishta shprehin qytetërimin e akëcilës shoqëri.

Po ku është shoqëria kosovare në këtë kontekst?

Të hedhim një vështrim të shpejtë tek emërtimi i rrugëve në Prishtinë, sa për të parë që edhe kur burrat e

hapin zemrën ndaj përfshirjes së sa më shumë grave në këto emërtime, ata ngelin pa ide, nuk u bien ndër mend asnjë grua e merituar, por në kokat e tyre vlojnë Azemat, Ademat, Bajramat, Longarat... e kështu deri në pre-histori...

Natyrisht tek gjyshërit e supozuar pellazgo-iliro-dardano-albano-kosovarë...

Një komision i ngrehur nga Asambleja komunale e Prishtinës, ka propozuar rishtas emërtimin e 171 rrugëve, kurse katër janë lënë "rezervë", pra nuk janë pagëzuar.

Dhe nga ato 171 emra, dominojnë burrat e dheut, kurse anëtarëve të komisionit i kanë ra ndërmend vetëm 7 emra grash!?

Nganjëherë ishte thirrur në ndihmë edhe folklori popullor ose kujtesa e popullit, për personazhe rapsodish, që nuk janë historikë, ose së paku jo të mbështetur në faktin shkencor dhe në këtë kontekst, thjeshtë ka mund që ndonjë rrugë në kryeqytetin kosovar të pagëzohet edhe "Kanga e gjarpnit", ose "Qika paturëshë"!!!

Nëse nuk viente ndonjë kriter më serioz, për propozim dhe arsyetim, pse të mos ketë Prishtinë edhe ndonjë rrugë të bazuar në legjendat dhe besëtytnitë popullore, si këto që

theksova më parë!?

Më këtë listën e fundit, ndër emrat e propozuar dhe të miratuar me shumicë të madhe votash, kanë zënë vend vetëm 101 njerëz të kulturës, artit, arsimit si mjekë, arkitektë, muzikantë, aktorë, profesorë, kundruall 552 heronjve, luftëtarëve e veprimtarëve politikë, antiosmanë e ballistë antikomunist, pastaj kuislingë (Xhafer Deva e Rexhep Mitrovica) e partizanë komunistë që nga Ganimete Tërbeshi e Qemal Stafa e deri te Fadil Hoxha, si dhe politikanë komunistë Mahmut Bakalli, Nebi Gashi e Nazmi Mustafa...

Por jo edhe Drita Dobroschi (veprimtare politike, kryetare e Dhomës për Edukim dhe Kulturë në Parlamentin federal të ish- Jugosllavisë dhe bartëse e funksioneve politike në Kosovë.)

Ndërkohë që harrohen njerëz që e kanë bërë këtë Kosovë edhe nga fusha e mësuesisë, sportit etj; pse jo edhe Lah Nimani e Mentaz Allajbegu...

Dihet, popujt e vegjël dhe të vonshëm në histori vuajnë nga kompleksi i madhësisë së projektuar dhe në këtë mësimje përvetësojnë figura të mëdha, duke i shpallur "tanët" pa ndonjë mbulesë fak-

tografike.

Në këtë vazhde, Prishtina aktualisht i ka tre Perandorë, Dioklecianin, Justinianin dhe Lekën e Madh (Aleksandri i Maqedonisë); Gjashtë mbretër (Agron, Bardhyl, Genc, Longar (ky madje dy herë), Pirro, Zogu I; e një mbretëreshë, Teutën, po jo edhe emrin Nana Mbretëreshë, Geraldine, si dhe një Prince (Wilhelm Wied) por asnjë princeshë!?

Po ashtu ka plot emra hoxhallarësh e priftërinjsh e shenjtorësh, që nga Papa Gjon Pali II, At Zef Pllumi e Imzot Nik Prela, por jo edhe Zoja Ruzare!

Katër pashallarë otomanë figurojnë në adresat e rrugëve prishtinase, Ali Pashë Gucia, Mehmet Pashë Deralla, Ali Pashë Tepelena, Maliq Pashë Gjinnolli (po jo Muhamed Aliu - Themeluesi i Egjiptit modern) dhe ky fakt të çon pikërisht në mendësinë otomane, ku asnjëherë asnjë grua s'u bë Pashë, por të gjitha robëresha dhe ndonjëra më me fat sulltaneshë. "Nxjerrjen" e gruas nga historia shqiptare, Mai e sheh edhe si trashëgimi pesëshkulllore osmane.

Në këto lista, ka boll shkrintarë, po jo edhe Anton Pashku e Azem Shkreli!?

Dhe sidomos jo ndonjë shkrintare kosovare si Hida Halimi p.sh. ose ndonjë mendimtare a poete e përmasave botërore si Hannah Arendt apo Wislawa Szymborska!?

Ka shumë muzikantë, por jo edhe Rexho Mulliqi; e posaçërisht jo Nexhmije Pagarusha, Nazmije Hoxha e Fitnete Rexha...

Shumë aktorë prej Aleksander Moisu deri te Bekim Fehmiu e Faruk Begolli, por jo edhe piktorët Muslim Mulliqi e Nysret Salihamigjijiq; dhe posaçërisht jo Melihate Ajeti, Adriana Abdullahu, Naxhije Deva, Meribane Shala dhe Lajde Sopi...

Pra Prishtina i ka dy Longara, dy Bajram Curra, dy Xheladin Kurbalia... dhe asnjë dëshmore të Jasharëve të Prekazit, si Nana Zahë dhe Adilja, gruaja e Ademit (dëshmore), po edhe të Nurie Zekajt dhe Nanës Ajshe (atdhetare.)

Do të lexoni tabelat me nëntë Rexhepa (një nga ta kryeministër nazist), nëntë Mehmeta, tetë Ahmeta, gjashtë Saliha, po jo Sali Berisha; pesë Syla e Sylejmana, pesë Abdyla, pesë Alia, pesë Bajrama, pesë Bedria, katër Tahira, katër Azema, katër Hasana (po jo Hasan Prishtina); gjashtë Ibrahimia (po jo Ibrahim Rugova, thonë se do të ngrihet Sheshi me emrin e tij), pesë Uka e Ukshina; gjashtë Ismeta, gjashtë Afrima, do Agima e kështu më radhë, sipas hartës tradicionale të homonimeve shqiptare-kosovare.

Nëse kriteri i mosemërtimit të rrugëve me emra njerëzish të gjallë është thyer me mbështetësit e padyshimit të kauzës së Kosovës si Bill Clinton, Madeline Albright, Jamy Shea dhe me Bob Dolle atëherë pse të mos emërotoheshin rrugë edhe me emrat e Nexhmije Pagarushës (këngëtare), Sahadete Mekulit (mjeke), Natasha Kandiçit (humaniste).

Nëse aq shumë u pëlqen kosovarëve Miss Edith Durham pse të mos u pëlqejë edhe Christine Von Kohl, që ishte avokatja më e zëshme e Kosovës në Helsinki Watch dhe në medat austriake, që influencoi së këndejmi edhe Qeverinë austriake në krah të çështjes së Kosovës.

Së këndejmi nga tre bulevardet prishtinase vetëm një mban emrin e një gruaje (Nëna Terezë), kurse nga dhjetë sheshet e kryeqytetit katër mbajnë emra grash, si: Miss Edit Durham, Xhevë Lladrovci, Medlin Olbrajt dhe Shote Galica.

Rrugët e Prishtinës i kanë shënjëzuar 20 gra, prej të cilave vetëm katra vijnë nga fusha e artit dhe kulturës, Tefta Tashko, Marije Krajaj, Katarina Josipi dhe Musine Kokalari.

Të tjerat vijnë nga lufta dhe veprimtaria politike...

OPINION

Feminizmi sot: nevojë apo ekstravagancë?

Por, përkundër mendimit mjaft të popullarizuar se feminizmi ka shkaktuar ndryshime marramendëse kulturore në dobi të femrës, megjithatë lëvizja e gruas vazhdon të jetë një nga lëvizjet më efikase dhe më të dobishme për barazinë shoqërore...

Lindita Tahiri

Përgjithësisht besohet se feminizmi i ka arritur qëllimet e veta, madje ka dhe mendime se këto qëllime janë tejkaluar. Doris Lessing, fituese e çmimit "Nobel" dhe autore e romanit ikonik për feminizmin Fletorja e artë thotë: "Nuk kam asgjë të përbashkët me feministet, ato janë shumë të ngurta dhe të vrazhda, të lënë përshtypje se nuk mund të pajtohesh e as të kënaqesh me meshkujt shoqëria e jonë ka krijuar pavetëdijshëm një paragjykim se vajzat janë të këndshme dhe djemtë janë të këqij" (Lessing: 2001). Por, përkundër mendimit mjaft të popullarizuar se feminizmi ka shkaktuar ndryshime marramendëse kulturore në dobi të femrës, megjithatë lëvizja e gruas vazhdon të jetë një nga lëvizjet më efikase dhe më të dobishme për barazinë shoqërore duke trajtuar çështje të rëndësishme thelbësore siç është shndërrimi i femrës në objekt apo konsumi i ndërlihdur me "industrinë e seksit".

"Ku shkuan gjithë ato femra interesante?" pyet autorja Nina Power, në librin e saj Gruaja njëdimensionale (2009) (që aludon në titullin e Marcuse Burri njëdimensional (1964)), dhe vazhdon më tej: "A thua kaq lehtë u plotësuan dëshirat e feministeve, me vetëkënaqësinë në parajsën e shopping-ut, me tringëllimën e byzylykëve lepu-rushash të playboy-it dhe me depilimin e vijave të bikinit?".

Për rrezikun nga ideali i uniformizuar dhe i standardizuar i bukurisë femërore mund të debatohet gjatë, por gjithsesi sot mbizotëron bindja se bukuria e femrës në radhë të parë gjendet tek pamja e saj, prandaj dhe 'recetat' për bukurinë femërore janë përhapur dhe shpeshtuar aq shumë sa madje janë shndërruar edhe në një "kundërveprim të fuqishëm ndaj feminizmit, kundërveprim që e shfrytëzon standardin e bukurisë femërore si armë politike për ndalimin e përparimit të gruas" (Kat Banyard. 2010). Madje dhe në rastet kur femra arrin fuqi supreme vendimmarrëse politike siç është rasti me Presidenten në Kosovë, mediat manifestojnë një diskurs paragjykes gjinor dhe e angazhojnë publikun më shumë me tema lidhur me dukjen dhe veshjen e saj, madje edhe me dukjen e gjuhës dhe tingëllimin e të folurit të saj, se sa me përm-bajtjen dhe domethënien e asaj që flet Presidentja. Për më shumë, edhe në mjedisë që konsiderohen ndër më të avancuarat nga aspekti i barazisë gjinore, siç janë SHBA-të, fushata e kandidatës femër për presidenten dëshmoi po këtë imazh stereotipikisht të automatizuar për gruan si kategori e shoqërisë që i takon sferës së amvisërisë dhe që nuk përket në mjedisin politik dhe nuk meriton të jetë pjesë e procesit vendimmarrës. Natyrisht se raportet gjinore

janë ngushtë të lidhura me raportet e fuqisë dhe pushtetit, dhe ato nuk transmetohen vetëm përmes vendimeve të mëdha, si për shembull përcaktimi për kuotën e deputeteve femra në Parlamentin e Kosovës. Raporti i pabarabartë i pushtetit mes dy gjinive transmetohet me gjëra të imazhet e reklamave, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në krijimin e paragjytimeve dhe stereotipave për femrën, në konstruktimin shoqëror të femrës si një genie e dukjes, dhe jo e përmbytjes. Një diskurs i tillë me paragjytime gjinore, nuk kursen asnjë sferë të hapësirës publike, që nga reklamat e çamçakëzëve, këngët e popullarizuara, editorialet hijerënda, deri te fletëpalosjet për regjistrim në universitetet e shumta të trevave shqiptare. Për më shumë, kjo ideologji rozë është befasisht e pranishme edhe në prodhimet mediatike që pretendojnë të jenë avangarde dhe të kenë marrë pikërisht rolin kritik dhe korrigjues të shoqërisë.

Për shembull, parodia kritike "The Simpsons" në Kosovë, me gjithë fuqinë e ironizimit dhe origjinalitetin në trajtimin e realitetit të Kosovës, megjithatë shpërfaq seksizëm të skajshëm në portretizimin e femrës. Po kështu bën nga ana tjetër e kufirit emisioni "Fiks fare" ku, me gjithë ironinë e mprehtë që pothuaj nuk lë pa prekur asnjë dukuri të rëndësishme për realitetin shqiptar, shndërrimi i femrës në objekt arrin përmasa vulgare. Madje, edhe një mendësi e re dhe premtuese, me frymë të shëndoshë rinore dhe ardhmërie, që po mëton ta rikthejë komunikimin brenda komunitetit, komunikimin e dëmtuar deri në kufi të anormales- Aleanca Kuqezi, në një nga manifestimet publike e shfaq patriotizmin përmes flamurit kombëtar të qepur si fustan me dekolte për vajzat e reja aktiviste, roli i vetëm i të cilave është që t'i ofrojnë vijat e gjymtyrëve të trupit për flamurin (edhe pse cinikët pas-feministë do të thoshin se më mirë na del me shqiponjën dekolte se sa me flamurin me gjashtë asteriks).

Sidoqoftë, kjo ideologji e pabarazisë gjinore dhe ky pushtet "i padukshëm" i gjinisë "së fortë" është më i fuqishëm, pikërisht sepse duke qenë gjithandë rëndomësohet, dhe nuk vërehet lehtë. Ai për nga natyra është pushtet kognitiv, i mbështetur në internacionalizimin e automatizuar të normave të caktuara gjinore, dhe manifestohet në veprimet tona të përditshme dhe në rutinën e prodhimeve gjuhësore që gabimisht perceptohen si të natyrisht dhe legjitime.

A mund ta përmirësojë feminizmi këtë perceptim? Mund ta përmirësojë vetëm pasqyra magjike, atëherë kur gruaja do ta pyesë: "Pasqyrë moj pasqyrë, kush është më e mençura në botë?"



Ulrike Lunacek

Disa gjëra të imëta bëjnë ndryshime të mëdha në jetën personale të njerëzve. Kur kam folur për herë të fundit me Rrjetin e Grave të Kosovës, shpalosa një pjesë të rrëfimit tim, dhe luftën e vazhdueshme pretenduese dhe konfirmuese të vendit tuaj, si një grua në një botë të dominuar ende nga burrat - në Kosovë, në Ballkanin Perëndimor, në Evropë dhe në botën anembanë. U rrefeva pjesëmarrëseve sesi u mësova të isha në ballë të takimeve dhe të kërkoja ta merrja fjalën ndër të parat në një debat - dhe jo në fund, kur mund të ishte tepër vonë që të më dëgjohej fjala.

Dhe isha shumë e befasuar kur një grua e moshuar kërkoi fjalën dhe tha se ajo e kishte marrë fort afër zemrës komentimin tim dhe se në të ardhmen do t'i mbante mend fjalët e mia. Dita Ndërkombëtare e Gruas është një prej atyre ditëve kur ne duhet t'i kujtojmë gratë që ishin para nesh, dhe të përdorim shembujt e tyre për ta fuqizuar veten dhe të tjerat, me qëllim që t'i sfidojmë dhe ndryshojmë strukturat patriarkale që mbizotërojnë, ku më pak e ku më shumë, në të gjitha pjesët e botës. Kur isha rioshe, nuk kishte femra në botën e politikës dhe ekonomisë - së paku asnjë prej atyre që mund të shiheshin në lajme televizive ose nëpër gazeta. Kjo ka ndryshuar, por jo mjaftueshëm. Eshhtë teoria e "masës kritike", që argumenton se neve na duhet dhënë hapësirë prej tridhjetë për qind në çdo fushë, me qëllim të shënjojme ndryshim real dhe të qëndrueshëm.

Në këtë sens, gratë e Kosovës tashmë kanë shënuar një hap përpara drejt arritjes të qenë një masë kritike: Në parlamentin tuaj, një e treta e deputeteve duhet të jenë femra, dhe kjo duhet të sigurohet edhe në lista zgjedhore. Dhe ju e keni një grua presidente, e vetmja në Evropën Juglindore (të tjera nuk ka shumë as

në Bashkimin Evropian).

Natyrisht se nuk mjaftojnë vetëm shifrat: "Të qenët grua nuk është vetëm një shifër sa për sy e faqe të një programi", por është një fakt se në përgjithësi gratë janë më pak të vetëshfaqura, sesa burrat, dhe kështoj shpeshherë mendojnë se dinë sa duhet, se nuk kanë studiuar sa duhet, se nuk janë mjaft të përgatitura, nuk duan të presin dhe të shohin, e kështu me radhë - ndërkaq burrat në përgjithësi kanë mësuar fort ta prezantojnë veten, madje edhe në qoftë se dija dhe përvoja e tyre nuk është e mjaftueshme për një post. Studimet gjithashtu tregojnë se burrat kërkojnë paga më të majme kur aplikojnë për një vend pune, sesa femrat - ne jemi shumë modeste! Prandaj, transparenca për të ardhurat duhet të jetë një detyrim për çdo kompani dhe institucion publik, sikur ndodh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo në shtetet skandinave. Jam fort e bindur se grave iu duhen dy aspekte për të ardhur më shumë në shprehje, si dhe për të marrë dhe ruajtur pozitën tonë të drejtë në shoqëri: Pavarësia ekonomike dhe emocionale. E para është goxha e qartë: duhet t'i keni të ardhurat tuaja materiale - e për këtë arsye është themelore një edukim i mirë! E dyta u referohet grave që duhet t'ia dinë vlerën vetes: nëse nuk u shkoqet nga mendja se vlera juaj si një genie njerëzore në thelb përkufizohet thjesht në të qenët një grua dhe një nënë, në shërbim të të tjerëve, duke përcuar vlerën dhe identitetin tuaj nëpërmjet një burri - bashkëshortit dhe babait të fëmijës tuaj - atëherë e huqni aspektin fillestar të identitetit, që ka për qëllim gjetjen e vlerës brenda unit tuaj si një krijesë njerëzore. Kjo është themelore dhe kjo duhet të jetë pjesë e edukimit fillestar të fëmijërisë, kopshtit të fëmijëve dhe edukimit fillor, në familje dhe në shkollë: Djemtë, ende, si një rregull, mësohen ta shfaqin veten në qendër të vëmendjes, derisa vajzat mësohen të kujdesen sesi të tjerët bëjnë dhe thonë, dhe të kujdesen për të tjerët, e jo në radhë të parë për vetveten. Tani të dyja gjërat janë të domosdoshme për një genie të kompletuar njerëzore: shpërfaqja e vetes në qendër të vëmendjes, dhe në të njëjtën kohë, të tregoni kujdes për të tjerët. Problemi në shoqëritë tona, të

strukturuara në mënyrë patriarkale, është se ende këto vlera i atribuohen kësaj, apo asaj gjinie. Dhe nëse një grua vendos të mos martohet dhe/ose të mos ketë fëmijë, ose madje të jetojë me një grua tjetër, ajo konsiderohet se nuk qenka një 'grua e njëmendtë'? Në anën tjetër, burrat që kanë bërë bajagi vjet dhe nuk janë martuar, quhen beqarë, me një konotacion shumë pozitiv. Femrat e pamartuara që kanë bërë goxha vjet konsiderohen 'virgjëresha të plakura', një atribut shumë nënçmues.

Fuqizimi gjithashtu nënkupton një luftë të fortë kundër dhunës ndaj grave. Është një prej krimeve më të tmerrshme. Nëse marrim parasysh se një në tri gra do të dhunohet ose rihet në jetën e saj, dhe se shfuqizimi dhe nënvlerësimi i grave është një zhvlerësim i vetë jetës - atëherë pse ne humbim kohë kot dhe përsëri na shfaqet pyetja se pse lufta kundër dhunës ndaj grave nuk është një prioritet numër 1 në mbarë botën. Kjo i mban gratë peng të frikës dhe zemërimit - të dyja baza shumë të këqija për priqje drejt një jete të suksesshme dhe të plotësuar.

Dhe ta merr mendja se na duhen ligje dhe rregulla për të arritur, një ditë, barazinë dhe të drejtat e barabarta: Kuota (si 33-përqindëshi i Kuvendit të Kosovës), transparenca në të ardhura: tregoni çfarë paguani (për biznesit), 'tregoni çfarë përfitoni' para punëtorëve dhe të punësuarve. Ligjet për të siguruar paga të barabarta për punën e njëjtë - kontrollojnë këtë. Dhe ligje e veprim qeveritar për ta luftuar varfërinë e grave, sidomos në mesin e grave të pamartuara dhe të atyre të moshuara.

Veprim afirmativ do të thotë se nëse një burrë dhe një grua janë barabartë të kualifikuar për një vend pune, atëherë të zgjidhet një femër për atë vend pune - derisa pesëdhjetë për qind e grave dhe pesëdhjetë për qind e burrave janë të përfaqësuar në çdo fushë dhe në çdo nivel hierarkie të jetës publike dhe të kompanive private. Gjithashtu është shumë me rëndësi që të merren femra "që mund ta mësojnë punën" derisa do të shoqërohen me një kujdes të shtuar. Kjo gjithashtu do të krijojte mundësi të mira për gratë dhe femrat e reja, si dhe për fuqizimin e tyre.

Dhe natyrisht se i rëndësishëm është edukimi, edukimi, edukimi - sepse pa të, asnjë grua (as burrë) në botën e sotme nuk ka mundësi të ketë një vend pune dhe të ardhura me të cilat do të mbijetojë dhe jetojë, dhe që i japin bazë për t'i shkuar fjala të thotë JO, kur ju nuk dëshironi të zieni, pastroni, bëni dashuri, ose çfarëdo qoftë, dhe ju fuqinë madje për ta braktisur bashkëshortin tuaj kur ai ju rrah dhe abuzon, ose madje ju dhuron ju dhe/ose fëmijët tuaj. Ne porsa patëm një performansë jashtëzakonisht të suksesshme të "Monologët e vaginës" të Eve Enslrit në Parlamentin Evropian, ku nëntë eurodeputete nga nëntë vende anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë dhe mua, lexuam nëntë rrëfime të grave të ndryshme të botës; një ushtrim mbresëlënës dhe fuqizues, që qel sytë për ashpërsinë, dhe gratë e bukura që e përjetojnë atë. Kishim më shumë se pesëqind njerëz në audiencë, një mbështetje frymëzuese për vazhdimin e luftës për të drejtat e grave.

A jemi 'virgjëresha të plakura', shtëpiake të moshës mesatare, gra të zëna pas karrierës, nëpunëse të angazhuara, apo bukurorë të reja: nuk varem nga atributet e burrave për ne, jemi gra të njëmendta, dhe kjo është ajo çfarë duam të jemi - dhe mbajeni në mend këtë, festojmë Ditën Ndërkombëtare të Gruas që 101 vjet!

Editorial për botimin e veçantë - Koha për Gratë

(Autorja është anëtare e Parlamentit Evropian për të Gjellbrit/EFA-s nga Austria dhe raportuese për Kosovën)

EDITORIAL

Gra të njëmendta

Grave u duhen dy aspekte për t'u shpërfaqur, si dhe për të marrë dhe për të ruajtur pozitën tonë të drejtë në shoqëri: Pavarësia ekonomike dhe emocionale



UNISEX

Vendi si Kuvendi

Në kërkim të kuptimit të subjektit grua, gjuha që përdoret në zhargonin kosovar nuk është maskuliniste, nuk është tipike as për sistemin tradicional, por i kthen gratë dhe burrat në tipea të shoqërive para tradicionales..



Sibel Halimi

Shoqëritë moderne po e rikthejnë debatin për krijimin e kuptimit të ri të femërores, duke shtruar pyetjen esenciale për subjektin e saj, nëse trupi është vetja apo ai ka pavarësinë autonome dhe mbetet i pa kontrolluar nga shoqëria. Vetja, për shkak të pozitës sociale është lënë në duar trupit dhe në këtë rast trupi, veçanërisht ai femëror po bëhet mjet i përdorimit për qëllime të caktuara nga formacione të ndryshme shoqërore. Prandaj, jo rastësisht çështja e trupit femëror u teorizua, ngaqë trupi u bë vend i shtypjes, detyrimit dhe viktimit për gratë, me të cilat ato janë pozicionuar e gjykuar t'i kushtojnë më shumë rëndësi dhe t'i shërbejnë "tjetrit".

Në kërkim të kuptimit të subjektit grua, gjuha që përdoret në zhargonin kosovar nuk është maskuliniste, nuk është tipike as për sistemin tradicional, por i kthen gratë dhe burrat në tipea të shoqërive para tradicionales.

Leksiku maskulinist i deputetëve

Mendimet në formë proverbiale zakonisht shpërfaqin aftësinë dhe kreativitetin përkufizues të një fenomeni, individit a situatës. Një grumbull fjalësh të tilla, të përmbledhura në një botim kalendarik të Kuvendit të Kosovës, u bënë pasqyrë reale e asaj se çfarë në të vërtetë mendojnë burrat nga godina e legjislativit të vendit tonë, jo vetëm për gratë e ulura përkrah tyre.

As më shumë e as më pak se mendimi që ekziston i skalitur prej kohësh në kokat mashkullore kosovare për gruan si mjet riprodhues e ndihmës në të gjitha rastet. Asgjë, e re,, përpos, retushim i një mentaliteti patriarkal.

Në fjalitë e shkruara nga deputetët, të cilat me një analizë të thjeshtë vërehen se shumica janë plagjiat i zvetënuar i proverbeve të njohura për gruan, vizatohet qartë portreti i një pjese të burrave kosovarë, në sytë e të cilëve gruaja del të jetë madje edhe para përcaktimit të sistemit tradicional të vlerave.

"Heshtja dhe modestia janë stolla më e bukur e gruas". E ç' e do kur në institucionin që dominohet nga burrat më së shumti heshtin ata. E një burrë tjetër, nuk ka hezituar ta thotë se "Femrat dashurojnë fitimtarët, andaj i lejojnë edhe t'i pushtojnë". Prandaj burrat shndërrohen në "speleologë", por asnjëherë nuk arrijnë ta dëshifrojnë në të vërtetë qenien grua.

Ama, prapë së prapë leksiku maskulinist zor të hiqet nga përdorimi, madje edhe nga ata, të cilat kanë arritur njëfarë prestigji në shoqëri, duke përfshirë këtu edhe deputetët, një pjesë e të cilëve arrijnë nëpërmjet 'kuotës' së fotokopjuar.

Heshtja, amësia, dashuria, mistri, dobësia, xhelozia, bukuria janë atribuime më tipike që iu dedikohen grave në vendet patriarkale që asnjëherë nuk arrijnë ta shohin gruan përtej skemës së tyre mentale maskuliniste.

Gruaja, asnjëherë nuk u kuptua përtej dashurisë dhe mundësisë që

ofron ajo. Ajo u konceptua si qenie e heshtur, prandaj për një deputet "Heshtja është ari i vetëm që kanë femrat". Pra, një kërkesë kjo për ta shndërruar gruan në enigmë/mister, qëllim i fundit i të cilës është përtëritja e racës. "Gruaja është enigmë, qëllimi i saj është fëmija". Praktikisht, një pamje tipike kosovare, ku gruaja nëse nuk del e pëlleshme, merr një dënim moral, duke i shkaktuar krizë në jetën e saj. Kësisoj, ajo përjeton një stigmatizim, fosilet e të cilat edhe sot e kësaj dite në vende malore nëpër fshatra kosovare mund të jenë prezente.

Ky proverb qartazi, rikthen idenë e mitizimit të pleshmërisë së saj. Pra, gruaja nëse nuk ka aftësi riprodhuese, potencialisht mbetet e rrezikuar, ngase si e tillë nuk i sjell stabilitet familjes, rrezikon mirëqenien e saj.

Gruaja sipas shkruarëve të këtyre proverbeve qenka gjithçka çfarë i ka dhënë kuptim mendimi dhe gjuha maskuliniste. Pse deputetët burra kanë nevojë në rrethanat e reja shoqërore t'i kthehen dhe t'i bluajnë idetë nga lashtësia prapanike e shoqërisë në përgjithësi. Kjo ta kujton maksimumin e njohur "Si është vendi, bëhet kuvendi".

Ridimensionimi i qenies grua është një proces dinamik dhe në asnjë mënyrë ajo nuk mund të shihet e ndarë nga shoqëria, por as si një prodhim "sui generis" kundrejt burrave. Thjesht është aksiomatike se gruaja është imazh i burrit dhe anasjelltas, ndaj çdo tendencë për ta linquar gruan si në proverbat e kuvendarëve është rikthim në debatin ku gjinitë zakonisht hyjnë me konstatime përfundimtare.


Çlirimi i gruas sado pezhorativ në kuptimin e përdorimit të konceptit, si fuqi bëri përpjekje të emancipohet vetëm nëpërmjet paraqitjes së saj në relacion me trupin dhe paraqitjen e saj kundrejt mashkullit. Kjo tendencë nuk i ka mundësuar një zhvillim autentik dhe thelbësor të saj, ngase ajo nuk arriti të çlirohet nga përpjekja dhe fuqia e dëshirës së pushtetit të burrave për ta parë atë si trup e asnjëherë përtej saj.

Subjekti grua kundër nga aspekti tradicional identifikohet me të kaluarën - me gruan në margjinë, ndërkaq nga këndi modern, ajo vihet në qendër si një aks i rëndësishëm shoqëror. Megjithatë, përkundër fuqisë së dëshiruar që subjekti grua të shihet vetëm në konceptimin e dukjes, ajo sot është më shumë sesa një vlerësim empirik, ajo është dhe si e tillë mbetet pjesë e pakontestueshme e zhvillimit shoqëror qoftë si rezultat i këtij zhvillimi apo si bartëse e tij.

Kuvendi i Kosovës u renovua në një pjesë të madhe të tij, porse mendësia e një pjese të njerëzve që ulen aty, përjetoi zhvillim retrograd. Ky institucion miratoi shumë ligje e që në parim janë demokratike, zgjodhi presidenten e parë në Ballkan, jo me propozimin e vet, por nuk arriti asnjëherë të ofrojë qasje moderne sa i përket trajtimit dhe respektimit të gruas. Tendencë për ta gozhdur gruan në rolin e saj tradicional, i kapërcen kufijtë e institucionit më të lartë në vend.

Proverbat- interaksion social

Outi Lauhakangas në studimin e tij mbi proverbat vë në pah se nuk ka proverb pa mesazhin e tij shoqëror. Sipas tij edhe arti është krijuar për hir të burrit, prandaj ai



thotë se arti nuk mund të shihet i ndarë nga shoqëria, ngaqë ajo është pasqyrë e jetës reale midis njerëzve. Lauhakangas, ofron shtatë paradokse në interaksionin social nëpërmjet të cilave funksionojnë proverbat në një kulturë të caktuar. Ato luajnë rolin e "parashikueshmërisë" dhe shpeshherë përdoren në formë të sugjerimit në interaksion me të tjerët. "Burri nuk fol dy herë" është një nga proverbat, në të cilën vihet në pikamë autoriteti i ndërtuar prej kohësh i burrit. Duke qenë i rritur në një mjedis patriarkal, ky burrë është shndërruar në personifikim të një autoriteti të pakontestueshëm. Kjo gjithashtu lidhet edhe me një ves që ndërkohë është shndërruar në njëfarë kodi moral, ku burri zakonisht paraqitet "mendja" dhe ku fjala e tij konsiderohet të jetë vendimtare. Megjithatë, rastet kësisoj, të ndërtimit të një autoriteti të pakontestueshëm, nuk i referohen gruas. Të shumtën e rasteve, ajo paraqitet si mbajtëse e ekonomisë familjare.

Në këtë kontekst, "Familjariteti" është ndarja tjetër që bënë Lauhakangas për të përshkruar se si në familje shpeshherë përdoren figurat e ndryshme të rëndësishme për t'i rikujtuar gjyshërit, derisa "Mirëmbajtja e hierarkisë dhe kontrollit", rangohet në ndarjen e pestë. Sipas saj, përdorimi i proverbeve, përkrah stratifikimin dhe kontrollin social dhe në të njëjtën kohë përforcojnë edhe autoritetin dhe fuqinë e një personi. "Lehtësimi i situatave" tregon përdorimin e proverbeve në kontekste të ndryshme siç është humori për të relativizuar situata të tensionuara.

"Rruga e të menduarit uniform" është çështja tjetër, e cila i karakterizon proverbat dhe të cilat sipas Lauhakangas në shumicën e rasteve përdoren në situatat sociale apo bëhen mjet i mendimit tradicional të një komuniteti të caktuar. Mirëpo, me përdorimin e tyre mund të shprehin edhe mendime të kundërta. Ndarjen e fundit të funksionimit të proverbeve, Outi Lauhakangas e vë

në të ashtuquajturin "Identiteti i një komuniteti - ndërkombëtar". Kësisoj, proverbat në shumë subkultura njihen si fjalime të këndshme dhe nëpërmjet të cilave shprehin relacione të ngushta brenda një subkulture të caktuar.

Gruaja dhe burri nga proverbat e dala nga vargjet, novelat apo romanet e shkrimtarëve nuk mund t'i ikë rolit tradicional, i cili përshkruhet në këto vepra. Madje, personazhi "grua" fillon të përshkruhet në një sfond tjetër socio-kulturor. Nëpërmjet metaforës dhe alegorisë, këto proverba nxjerrin në pah mendimin tipik të kohës për qasjen ndaj qenies grua "Gruaja është si puna e brumit, pos s' e shtype e po s' e ngjeshe, nuk vjen".

Produktiviteti i gruas shihej edhe si përcaktues i statusit të saj në familje. Për më tepër, një grua sterile ishte e gjykuar të përjetonte fatin e legalizimit të dhunshëm të poligamisë, ose në rastin tjetër edhe të merrte udhët, e gjykuar shkaku i "paaftësisë" së saj biologjike për të riprodhuar racën. Ajo mohohet në tërësi, nëse nuk arrinte ta trashëgonte familjen, ndaj krahasimet në proverba shprehin me një stil gjuhësor tejet subordinues "Gruaja pa fëmijë s' e njej lumturinë mesa shkretëtira lulen".

Formulimi gjuhësor i proverbeve ka bërë që gjinitë të mbeten peng i një rrafshi tradicional të formimit socio-kulturor. Mbase e gjithë kjo mënyrë e artit në mënyrë të padukshme ka ngjizur rolin tonë social edhe sot.

Të gjitha këto proverba, janë një thesar kulturor i krijuar në rrethanat të caktuara shoqërore. Në formë të zhargonit popullor, ato krijuan shtratin e vet shoqëror edhe në kohën e sotme, duke përfshirë shumë sfera jetësore.

Mesazhet proverbiale- orientim i gjinive në rolet sociale

Margaret Hasluck në veprën e saj "Kanuni" (Ligji i pashkruar shqiptar) shkruan se në shoqërinë

shqiptare, Kanuni i Lekë Dukagjinit vazhdon të jetë e pandashme nga mënyra e orientimit të vlerave socio-kulturore. "Ligji i pashkruar theksonte se burri është koka e gruas, kështu ai mund të ndëshkonte për mosbindje dhe për sjellje të keqe" vendosjen e rregullit në familje i përkiste burrit, andaj "Një lloj autoriteti koordinues është patjetër i nevojshëm kur shumë punëtorë që jetojnë në një çati, merren me detyra të ndryshme. Kështu Ligji i Pashkruar parashikon që çdo familje t'i nënshtrohet një sistemi patriarkal qeverisjeje në një zot shtëpie dhe të tjerët t'i binden atij".

Ligjet e pashkruara janë zhvilluar për t'i siguruar njerëzit, në mënyrë që të krijohet një ndarje e drejtë. Kjo mënyrë e ruajtjes së rendit shoqëror u bë më pas pjesë e sistemit ligjor, të cilin e zhvilluan për çdo aspekt të jetës së tyre. Prandaj, kjo mendësi tradicionale u bë e depërtueshme në të gjitha format e jetës shoqërore duke prekur edhe proverbat, si sentencë, fjalë e urtë apo maksimume e shprehur me pak fjalë dhe u bë popullore.

Ligjet e pashkruara janë të shkurtruara në mesazhet proverbiale që orientojnë gjinitë në rolet e tyre sociale. Prandaj, "Burri ka gjak e gruaja gjini" identiteti gjinor është i krijuar dhe i skalitur mirë nga ky ligj i pashkruar që më pastaj bëhet pjesë e mentalitetit.

Ndonëse, edhe në ditët e sotme kur ekzistojnë ligjet kushtetuese, ligjet e pashkruara mbeten në fuqi sidomos në rregullimin e marrëdhënieve familjare. Përcaktimi i pozitive të anëtarëve të familjes, ceremonitë e ndryshme (dasmat e ritualet) etj. vazhdojnë të udhëhiqen në mënyrë arkaike dhe rezistuese nga rrjedhat e reja bashkëkohore dhe që krijojnë mundësinë e jetësimit të skemave gjinore. Teoria e Sandra Bemit mbi skemën gjinore përshkruan rolin dhe rëndësinë negative që del nga tipizimi seksual. "Tipizimi seksual, rezulton pjesërisht nga asimilimi i konceptimit brenda skemës gjinore. Psh. një lexues mund të vërë re se burrat zakonisht përshkruhen si "të fortë", "të mëdhenj", "trima", ndërkaq gratë zakonisht përshkruhen si të "mira", "të ëmbla" dhe "të këndshme" e "të ndjeshme".

Roli shoqëror i gruas dhe burrit më pas kuptohet si normë që përcakton se si duhet të sillt njeriu në momente të caktuara dhe në mjedise të caktuara, prandaj ligjet e pashkruara bëhen subjekt i analizës për të treguar se si roli social superior dhe inferior brendësohet dhe orienton sjelljet e ardhshme të vetë individit, ndërkaq procesi i arsimit dhe relacioni i fëmijëve me sistemin shkollor ndihmojnë në formimin e identitetit gjinor si dhe në perceptimin e roleve gjinore.

Në këtë kontekst, del qartazi se edhe përkundër ekzistimit të ligjeve që janë në fuqi, roli i ligjeve të pashkruara ndikojnë fuqishëm në përcaktimin e roleve sociale për burrat dhe gratë në Kosovë.

Kësisoj ligji i pashkruar parashikon që çdo familje t'i nënshtrohet një sistemi patriarkal, qeverisje prej një zoti shtëpie, të cilin i binden të tjerët.

Andaj, paraqitja e imazhit të gruas në këto proverba, në esencë është një relacion midis kulturës patriarkale dhe mitizimit të kulturës falocentrike Kjo kulturë falocentrike po krijon formula misogjine, të cilat barten tek shoqëria, atë se çfarë jemi në esencë.

OPINION

Kuota, mundësi reale e arritjes së barazisë gjinore



Eglantina Gjermeni

Në momentin që diskutohej vendosja e kuotës gjinore për pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në një ligj, ka pasur edhe vazhdon të ketë argumente pro edhe kundër saj, të cilat deri diku janë të kuptueshme. Ajo çfarë të bën përshtypje, është se në diskutimet që bëhen harrohet me/ose pa dashje që pjesëmarrja e grave edhe vazhdon në vendimmarrje, në politikë apo përfaqësimi i tyre, nuk është edhe nuk mund të jetë “dhuratë” apo “lëshim” që i bëhet grave. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja është e drejtë njerëzore, e drejtë e secilit individ. E drejta e përfaqësimit është një e drejtë e barabartë për të gjithë, por në realitet kanë ekzistuar dhe ekzistojnë një sërë faktorësh me karakter social, kulturor, ekonomik, historik etj., që kanë penguar një përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në organet e zgjedhura, si dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave si votuese. Përkundrazi, për të kontribuar në zbatimin në praktikë të kësaj të drejte, përdoret mekanizimi i kuotimit, i cili është i përkohshëm edhe kërkon përmirësimin e përfaqësimit të dy gjinive në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Në thelb in e tyre, kuotat janë masa të përkohshme për rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar (të grave në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës) në vendimmarrje. Natyrisht, ato nuk janë masat e vetme, por përbëjnë një pjesë prej masave efektive në tërësinë e politikave dhe strategjive që ndiqen për këtë qëllim. Edhe pse në përgjithësi, në legjislatore nuk parashikohet një kohë e kufizuar në të cilën duhet të vendosen e të zbatohen këto kuota, ato duhet të konsiderohen si masa të përkohshme derisa të zduken barrierat për pjesëmarrjen e grave në fusha dhe nivele të ndryshme.

Nisur edhe nga përvoja e vendeve më të zhvilluara, prania e grave dhe vazhdon në nivelet më të larta të vendimmarrjes i shërben rritjes së cilësorisë së kontributit të gjinisë më së shqetësuar në bërjen e politikave. Nga ana tjetër, përfshirja e grave në këto nivele, nxit inkurajon, apo krijon klimën e nevojshme për të arritur këto rezultate. Përvoja e vendeve që kanë arritur standarde të larta në balancën gjinore në vendimmarrje, ka provuar faktin se nuk është vetëm zhvillimi ekonomik që influencën zbatimin si duhet të sistemit të kuotave, por ai lidhet ngushtësisht me vullnetin e partive politike për ta zbatuar atë. Përvoja e zbatimit të kuotës gjinore në Kosovë, rezultoi në suksesshme për të dytën legjislativë radhazi.

Konsiderohet e suksesshme, jo thjesht për zbatimin real dhe të plotë të kuotës gjinore, jo vetëm për ndërmarrjen e nismave ligjore në ndihmë të grave në Kosovë, por edhe se bashkëpunimi mes grave deputete në Parlamentin e Kosovës i kapërcën kufijtë e partive politike. Grupi i grave deputete në Kosovë është proaktiv dhe zhvillon një sërë aktivitetesh, të cilat i japin një fizionomi tjetër parlamentit të Kosovës, padyshim edhe vetë grave deputete.

Ndërsa në Shqipëri, përvoja në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, ashtu edhe në zgjedhjet vendore të vitit 2011, tregoi mungesën e vullnetit të partive politike për ta zbatuar plotësisht kuotën gjinore, si pjesë e ligjit për barazi gjinore. Padyshim, përvoja e grave deputete në Kosovë (dhe jo vetëm) na nxit të reflektojmë edhe të shikojmë se si mund të bashkëpunojmë duke synuar një përfaqësim të denjë të gra shqiptare në të gjitha nivelet vendimmarrëse.

Një filozof i madh thotë “Një udhëtim i gjatë prej 1000 mijlesh fillon me një hap të parë”. Zbatimi pjesëshëm i Ligjit për Barazi Gjinore në Shqipëri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, solli në parlament 23 gra, nga 10 që ishin legjislatore dhe 13 që ishin në detyrë në administratë apo pranim, por ishte vetëm një fillim. Padyshim deri këtu u arrit, pas një sërë përpjekjesh të shoqërisë civile, organizmave ndërkombëtare, grave parlamentare, institucioneve shtetërore, të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare që e konsiderojnë pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje si një tregues i një shoqërie demokratike. Edhe gjatë zgjedhjet vendore të vitit 2011 sërish nuk u realizua plotësisht kuota gjinore. Deri diku u përmirësua pjesëmarrja e grave në këshillat e bashkive apo komunave, por numri i grave si kryetare bashkish apo komunas mbetet sërish shumë i vogël. Për hir të së vërtetës, Partia Socialiste ka nivel më të lartë të përfaqësimit të grave krahasuar me të gjitha partitë e tjera, si në zgjedhjet parlamentare ashtu edhe ato vendore. I gjithë ky proces që ndodh është një proces rritjeje, emancipimi dhe transformimi i politikës, por edhe vetë shoqërisë shqiptare.

Shqetësimi (përtej përkatësisë partiake) konsiston në faktin se në varësi të performancës së grave deputete në këtë legjislativë (për shkak të zbatimit për herë të parë të kuotës gjinore), do të varet përzgjedhja e grave në listat e kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Kam menduar që në fillimet e përfshirjes sime në politikë (edhe nuk besoj se jam gabuar) që gratë deputete dhe performanca e tyre do të monitoroheshin, vëzhgoheshin edhe komentoheshin më shumë se sa deputetët burra, nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë shqiptare, si dhe nga i gjithë opinioni publik. Kjo edhe për arsye të thjeshtë se do të merrnin përgjigje, pyetje apo shqetësime të shumëllojshme “A e meritojnë gratë të jenë në politikë?” “A bëjnë dot politikë gratë?” “A do të përfaqësojnë gratë deputete nevojat e interesat e grave dhe vajzave?” “A do të zgjedhin këto gra modelin e graus së fortë, agresive apo të butë dhe femërore?” “A kanë bërë zgjedhjen e duhur kryetarët e partive duke i caktuar në lista këto gra?” “A do ta menaxhojnë dot këto gra balancën mes

jetës personale edhe asaj profesionale”.

Nga gratë deputete pritet që të ishin vetja e tyre, të performonin shumë mirë (si në komunikimin publik ashtu edhe në paraqitjen e jashtme), të dinin të bënin politikë (sa mirë do të ishte ta dinin edhe të gjithë burrat e angazhuar në politikë këtë gjë), të ndërmerrnin nisma ligjore edhe të diskutonin për çështje sociale, dhunën në familje, të drejtat e fëmijëve, etj. Pse presim dhe të kërkojmë që vetëm gratë të diskutojnë dhe ndërmerrin nisma ligjore për çështjet sociale, dhunën në familje apo të drejtat e fëmijëve? Këto janë çështje që prekin familjet shqiptare dhe të gjithë shoqërinë, kështu që secili prej nesh në sallën e Parlamentit apo jashtë saj mund edhe duhet të bëjë diçka për to. Padyshim parlamentin ka përgjegjësi shumë të madhe për të gjitha këto çështje që na prekin të gjithëve. Roli i grave mund të jetë më i rëndësishëm në këto fusha, për shkak të përvojave apo profesioneve të cilat mund t'i ndihmojnë të jenë më të përgatitura, më të ndryshme edhe më eksperte në trajtimin e tyre, por jam e sigurt që për shkak të larmisë së profesioneve, ekspertizës, njohurive që kanë gratë deputete si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kanë diskutuar, sugjeruar komentuar, analizuar projektligje të ndryshme (që trajtojnë jo vetëm çështje specifike të grave dhe fëmijëve) duke dhënë mendime profesionistësh, ekspertësh si dhe duke shprehur edhe qëndrime politike.

Ajo çka vihet re në shoqëritë tona në kërkim të një demokracie funksionale është se përdorimi i standardeve të dyfishta në vlerësimin e grave dhe burrave. Standardet e përdorura në (mos) vlerësimin e performancës së grave në parlament, janë të ndryshme krahasuar me performancën e burrave. Në momentin që një grua angazhohet në politikë pritshmëritë ndaj saj performancës së saj janë të ndryshme. Jo pak presin që një grua në politikë duhet të jetë një grua e “fortë” (pse jo burmëshë) që t'i mbijetojë politikës shqiptare, ndërsa të tjerë presin që gruaja deputete të luajë një rol “femëror” “të butë” dhe “paqësor”. Gjetja e një të mesme të pranueshme mbetet një sfidë e madhe për gratë deputete apo vendimmarrëse. Nuk besoj se burrat deputete përballen me këtë problem. Nuk është e lehtë që mentaliteti ynë tradicional të ndryshojë, po aq shpejt sa ndryshojnë ligjet. Standardet e dyfishta edhe në vlerësimin e performancës, janë në fakt një nga treguesit e diskriminimit gjinor që duam apo nuk duam ne na shoqëron edhe në sallën e parlamentit. Ndërkohë që edhe në rast se mes grave deputete ka prej nesh që kanë zgjedhur këtë apo atë model, apo edhe thjesht po krijojnë një model të tyre, sërish mesazhet edhe feedbacku që marrin oftojnë nga kolegë, qytetarë, apo analistë të medias është shumë herë kritik. Cili është realisht standardi edhe modeli që një grua në politikë apo jetën publike të marrë vlerësime pozitive? Nuk duhet të harrojmë faktin se jeta e asnjëris prej grave deputete në parlamentin e Shqipërisë apo Kosovës, nuk fillon ditën që u bë deputete. Secila ka një profesion, ka një karrierë, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e saj profesionale dhe përfshirja në politikë është një sfidë, por edhe

dëshirë për të kontribuar në këto nivele.

Diçka tjetër që pritet nga gratë deputete apo të angazhuara në politikë, është zbutja e politikës shqiptare, e cila karakterizohet nga agresiviteti, konfliktualiteti edhe është një politikë e cila nuk i ka dhënë qytetarit akoma marrëveshjen, kompromisin apo dialogun. Padyshim që është mision i vështirë, është edhe ai i duhuri, por që nuk mund edhe nuk duhet ta bëjnë vetëm gratë. Në rast se duam të integrohemi në Evropë, në radhë të parë duhet të sillemi si evropianë, të gjithë bashkë, vetë klasa politike duhet ta reflektojnë këtë qëndrim apo sjellje.

Ndërsa flasim për kuotën gjinore apo përfshirjen e grave në nivelet vendimmarrëse duhet të kemi parasysh se çështja nuk qëndron vetëm “se si të shtojmë numrin e grave” nëpër procese të ndryshme, por si të ri-formatojmë këto procese për të krijuar hapësirë e duhur për përfshirjen e barabartë të grave dhe burrave. Krijimi i hapësirave duhet të jetë ajo çka duhet bërë në familje, në shoqëri, në komunitet, në qeveri, patjetër edhe në parlament. Në radhë të parë kjo kërkon vullnet dhe angazhim politik të të gjithë aktorëve të përfshirë në politikëbërje dhe në ekzekutiv, duke konsideruar përfuturit që vijnë si respektim të të drejtave të njeriut, demokraci më e plotë edhe më përfshirëse, qeverisje më e mirë dhe një zhvillim më eficient të shoqërisë.

Gjithsesi, me realizimin de jure apo/edhe de facto partitë politike nuk mund të konsiderojnë se kontribuan mjaftueshëm për arritjen e një shoqërie të mundësive të barabarta. Kjo shoqëri mund të bëhet realitet vetëm atëherë kur perspektiva gjinore do të përfshihet në çdo aspekt të bërjes së politikave; kur vlerësimi i nevojave, hartimi i ligjeve, programeve dhe politikave, përcaktimi i buxheteve dhe vlerësimi i ndikimit të të gjitha këtyre proceseve politike do të siguronte marrjen parasysh dhe adresimin e barabartë të nevojave, interesave dhe ideve të burrave dhe grave. Mendoj se si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, jemi ende shumë larg këtij realiteti.

Jam e bindur që edhe në Shqipëri edhe në Kosovë ka shumë gra dhe burra të mençur, të zotë, të respektuar, që kanë dhënë edhe japin kontribute shumë të vlefshme edhe nuk janë angazhuar në politikë për arsye të ndryshme. Sigurisht, është zgjedhja e tyre edhe si e tillë duhet respektuar. Por, në kushtet që në shqiptarët në Shqipëri edhe në Kosovë jemi të lodhur edhe disgjatur nga politika, duhet që secili/secila në mënyrën apo përfaqësimin e vet të kontribuojë për ndryshimin e kësaj politike.

Ky proces transformimi të kryhet në drejtimin e duhur edhe të jetë i qëndrueshëm, duhet jo vetëm kontributi i grave, duhet një masë kritike e gjithë shoqërisë në Shqipëri e Kosovë. Kjo masë kritike siguron mbështetje, bashkëpunim, kritikë, si pjesë të një përfaqëseje edhe dëshirë për të ndryshuar shoqërinë shqiptare dhe transformuar atë në një shoqëri demokratike dhe të mundësive të barabarta.

(Autorja është deputete e Partisë Socialiste - Shqiptërie)

Koha e saj sapo ka filluar

Zëri i saj i veçantë ka bërë shumë profesionistë të këngës të rrëqethen. Lidhja e saj me këngën filloi në vitin 2004, kur mori pjesë në “Ethe e së Premtes Mbrëma” në Top Channel. Në këtë garë Rona doli e pesta për të vazhduar majat e karrierës deri sot kur ajo pret t'i përfaqësojë shqiptarët në Eurovision.

Në festivalin e këngës në Radio Televizionin Shqiptar, Rona mori pikët maksimale nga pesë anëtarë e jurisë, të cilët njëmendshëm vendosën që kënga “Suus” të jetë kënga konkurruese në Eurovision.

“Suus”, që në latinisht domethënë “personale”, përçjell tek publiku një përjetim të veçantë të tekstit dhe melodisë nga ana e këngëtares.

Rona do të jetë shqiptarja e parë nga Kosova që merr pjesë në Festivalin Evropian të Këngës, me këngën e kompozuar nga Florent Boshnjaku. Kjo është padyshim arritja e saj më e lartë deri më sot, ndonëse ajo ka marrë çmime të shumta dhe ka realizuar këngë që kanë qenë hite të mëdha për kohë të gjatë.

Hitet e saj jo rrallë kanë përcjellë mesazhe



Rona Nishiu

tek dëgjuesi. Një nga këto këngë e titulluar “A ka arsy”, të cilën Rona e kishte realizuar në bashkëpunim me Bim Bimma thërret për ndalimin e dhunës në familje.

24-vjeçarja me stilin e saj te veçante dhe flokët dreadlocks të cilat i mban prej që e mbajmë mend, është vajzë komunikative, e thjeshtë, euforike në natyrën e saj të butë dhe pa ndonjë make-up të tepruar.

Nga pak artistë në Kosovë, performon live në baret e vendit. Të gjithë i ka mahnitur me performancën e saj të këngës “Baresha” dhe këngëve të Michael Jackson.

Muzikantët profesionalë e krahasojnë atë me artistë të njohur botërorë si Aretha Franklin e Chaka Khan.

Kjo artiste e cila filloi me “Flakareshat”, shumë shpejt u shndërrua në ikonën e muzikës urbane të trojeve shqiptare.

Derisa vetë thuri vargjet e këngës “Suus”, në një moment të këngës Rona shkruan “Koha më për ne s'ka kohë”, ndërsa në fakt, të gjithë e dinë se koha për të veç sa ka filluar.

Me zërin e parë drejt skenës botërore

Nuk i mjaftonte që në muzikë të kufizohej vetëm me instrumentin e pianos, për të cilin po ndiqte mësimet për disa vjet. Ndonëse nuk kishte kënduar asnjëherë, pos për qejf, ajo ka goditur me herën e parë. Rina Bilurdagu ka fituar në edicionin e parë të spektaklit televiziv “The Voice of Albania”. Kjo i ka hapur dyert prizrenases, që të prekë majat e famës botërore.

Një kontratë dyvjeçare me shtëpinë e njohur diskografike “Universal Music” është shpërbliimi për Bilurdagun. Ajo kishte vendosur që të paraqitej në audicionet e spektaklit televiziv “The Voice of Albania”, për të ndryshuar jetën e saj. Ndërsa do të ishte Alma Bektashi, po ashtu këngëtarja dhe profesoresha nga Kosova që do të merrte në ekipin e saj, Bilurdagun. Për shtatëmbëdhjetë javë, shtatëmbëdhjetëvjeçarja nga Prizreni ka shkëlqyer në skenë, për të bindur publikun nga Shqipëria e Kosova që ajo duhet të jetë fituesja. Me zërin e saj ajo ka fituar simpatinë e publikut që në netët e para të spektaklit. Por ka ngjallur edhe debat. E Bilurdagu po e jeton ëndrrën e saj. Menjëherë kur ka përfunduar spektaklin i “The Voice...” Rina kishte deklaruar se ndjehej shumë e lumtur që puna e saj dhe mësuës së saj u kurorëzua me sukses.

Kur kishte mbetur vetëm me Marselën në finale, në raundin e dytë të votimeve, ka thënë se nuk e ka pritur se do të jetë fituese.

“Secili prej nesh e kemi pritë që mund të jemi fitues, për vetë faktin që kemi shkruar deri në finale. Por kur mbeta me Marselën nuk shpresova shumë. Ajo është këngëtare shumë e mirë dhe ka qenë një konkurrente shumë e



Rina Bilurdagu

fortë”, ka thënë ajo.

Bilurdagu është e vetëdijshme që e pret punë e madhe. Kontrata dyvjeçare që do të nënshkruajë me “Universal Music” do të mund t'i hapë asaj rrugë në tregun e muzikës botërore. Në kompaninë prestigjioze “Universal Music” kanë kaluar emra të mëdhenj të muzikës. “Kjo ka ndryshuar jetën time”, kishte thënë Bilurdagu.

Autoriteti i grave në shkencë

Shkenca, së paku ajo moderne, ka të bëjë, në një mënyrë shumë të veçantë, me pushtetin. Gjatë procesit (si është përshkruar nga Hannah Arendt) të dobësimit progresiv, në epokën moderne, të pushtetit në format e tija klasike, e vetmja formë pushteti që ende ruan fuqinë e saj e bile edhe përfunduar duke i përfshi dhe zëvendësuar të tjerat, është ajo e shkencës,

Diana Sartori

Po të shohim fushën e mendimit dhe studimit, që në përgjithësi quhet 'gjinia dhe shkencë', gjëja më e dukshme që vërejmë është se në dhjetë a pesëmbëdhjetë vitet e fundit, posaçërisht në punën anglo-amerikane, ka pas një zhvillim mjaft të rëndësishëm në këtë fushë, së paku kur shohim biografite gjithnjë e më të gjata që duhen cituar. Këto bëhen edhe më të gjata prej përpjekjeve të fundit, dhe shpesh mjaft kontraktuese, për të organizuar materialin ekzistues, dhe për të definuar saktësisht gjendjen e fushës. Përgjatë këtyre viteve, kam reflektuar mbi gjininë dhe shkencën, duke u munduar t'i lidh ato që kanë lindur në diskutimet anglofone me termet e debatit italian, që e kam më afër shtëpisë, dhe mënyra e sjelljes më ka kaluar nëpër disa faza. Fillimisht, ndjeva një kureshtje optimiste, që u kthye në distancë e mosbesim, dhe, tash rishtazi, prapë kam filluar të interesohem. Këto faza, për mua, janë shënuar nga dy 'shenja', që do të mundohem t'i shpjegoj.

Shenja e parë e pash në 1988, duke lexuar nga përmbledhja e pikave që kishin dalë në Barbara Imber dhe Nancy Tuana's në Hypatia, të ribotuar në përmbledhjen Feminizmi dhe Shkenca (Tuana 1989).

Imber dhe Tuana nisin duke thënë se 'ka konsensus ... se shkenca nuk është neutrale kundrejt vlerave, se shqetësimet kulturore/politike hynë në epistemologjinë, metodologjinë dhe përfundimet e teorisë dhe praktikës shkencore (Imber e Tuana 1988:139). Më bëri shumë përshkrim një pohim aq i hapur për rëndësinë e politikës në shkencë dhe në të menduarit mbi shkencën. Më dukej se ishte e kundërta, se kjo referencë në politikën dhe mënyra se si hyn ajo dhe si ndikon në aktivitetin shkencor më shumë bëhej, në debatin aktual, për shkak të një referencë jorefektive traditës marksiste dhe teorisë kritike në një anë, ndërsa në anën tjetër, një traditë më të re të kritikës epistemologjike të pozitivizmit, e jo që ishte me të vërtetë një vetëshqyrtim i lidhur me kuptimin, drejtimin dhe efektivitetin e politikave të grave. Si pasojë, mundësitë politike të feminizmit përfunduan si të varura në këto dy tradita kritike, përdërisa çështja e politikës së grave mbeti krejtësisht e shkatërruar nga koncepti tradicional i politikës. Kam menduar se ishte e vështirë që të paramendohet një dialog mes kësaj lloji tradite dhe asaj me të cilën jam e lidhur, për faktin se isha rritur në Itali në atë kohë dhe që rrënjën më të thellë e kisha lidhjen me reflektimin dhe praktikën politike të lëvizjes së grave. Si rrjedhojë, sjellja ime kundrejt debateve anglo-amerikane mbi gjininë dhe shkencën është shënuar nga ideja se mes nesh kishte një largësi pothuajse të pakapërcyeshme.

Shenja e dytë që e përmend vetëm se ma forcoi besimin, por po ashtu ma ndryshoi sjelljen. Në të vërtetë, disa prej pozicioneve që janë marrë tash së voni brenda këtij debati më duket se po i japin diskutimit një ndryshim të mirëfilltë në drejtimin e debatit, kështu që largësia nuk duket aq e madhe. Kjo ma bën më të lehtë që ta paramendoj mundësinë, e që besa edhe vlerën, e asaj se çfarë të përbashkëta mund të kenë debatet tona. Ky ndryshim fitimprurës u promovua nga gruaja që ndoshta ka kontribuar më së shumti në zhvillimin e debatit mbi shkencën, Evelyn Fox Keller, dhe që ka mundësuar diskutimin e gjithëpërhapur, në mesin e feministëve amerikane, të çështjes së konfliktit mes grave.

Libri i saj i bashkëredaktuar, Konfliktet në feminizëm, përfshin, bashkë me diskutimin e konflikteve

politike, një artikull të shkëlqyeshëm për konfliktet në shkencë, shkruar nga Helen Longino dhe Evelyn Hammonds. Bash në këtë artikull, dhe në kontekstin e konfliktit shkencor, gjeta 'shenjën' më të saktë se të dy traditat që i përmenda mund të konvergjojnë.

Helen Longino nisët nga intuita se konfliktet që po ndodhin përbrenda debatit për gjininë dhe shkencën mëshëfin terrenin e mirëfillt të argumentit. Përdërisa në sipërfaqe ka mospajtim mes mundësive epistemologjike ose filozofike, në realitet çështja ka të bëjë me mospajtime të natyrës politike, sidomos mbi atë se nëse dikush do ta ndërroj shkencën nga 'brenda' ose nga 'jashtë'. Megjithatë, këto dallime nuk konfrontohen si të tilla, dhe mira do të ishte sikur të mos përmenden. Pse kjo? Të gjitha hipotezat e Longino's sugjerojnë të njëjtin shpjegim: konfliktet 'thyhen përmes syve të babës'. (Hirsch e Keller 1990:176) kështu që gratë ndahen mes vete me ndarjet tradicionale të burrave, dhe luftojnë për një dhe të vetmin vend afër mashkullit. Ftesa që bën në paragrafin e saj të fundit na fton që të shohim se sa të reja i kemi argumentet, të lirohemi nga kufijtë e ngushtë që na janë caktuar nga kategoritë tradicionale- duke njohur faktin se kjo nuk do të thotë eliminim i mospajtimeve mes grave - dhe është baras me një ftesë për t'i ikë nënshtrimit ndaj imazhit 'të thyer përmes syve të babës tonë'. Me e lënë anash Helen Longino, dhe duke përdorë gjuhën e traditës të cilën e di shumë mirë, do të thosha, nënshtrimit simbolik atëror.

Ndërhyrja nga Helen Longino (si ajo e të tjerëve si Fox Keller, Hammonds, Teresa de Lauretis ose Jacquelyn Zita) tregon një vetëdije për domosdonë e lidhjes së perspektivave të hulumtimit të grave, që në këtë rast janë hulumtimi epistemologjik dhe shkencor, me një dimension politik më të mirëfilltë të reflektimit feminist të disa viteve të fundit. Një qasje e tillë e karakterizon stilin

e feminizmit italian (sikur e kanë vërejtur mirë. Psh, në Konferecën Ndërkombëtare të teorisë feministe në Glasgow në korrik të vitit 1991), që gjithmonë ka synuar mbajtjen e lidhjes së fortë me elaborimet teorike dhe praktikës politike, për dallim prej asaj që i ka ndodhë lëvizjeve feministe në vendet tjera, ku debati politik dhe hulumtimi 'akademik', nën tutelën e studimeve të grave, nganjëherë janë larguar (edhe pse ky i fundit pashmangshëm nxjerr fuqinë e vet prej përkushtimit që ka për t'u ndihmuar grave).

Lidhur me këtë çështje besoj se disa prej debateve italiane, posaçërisht puna e Kolektivitet të Librisë së Grave në Milan dhe 'mendimi i dallimit' teorizuar nga komuniteti filozofik i grave, Diotima, do të mund të ishte i dobishëm. Në veçanti, problemi që përfaqësohet me pushtetin e grave duhet pa në relacion me fushën kyçe të shkencës. Mendoj në fakt se problemi i pushtetit përfaqëson njëqëndrorë të elementeve komplekse

të ndërthurura që krijojnë situatën e tanishme të konfliktit (dhe, në disa raste, të qorrsokakut) në sferën e reflektimeve teorike e politike të grave në shkencë. Do të mundohem ta shpjegoj këtë më qartë.

Shkenca, së paku ajo moderne, ka të bëjë, në një mënyrë shumë të veçantë, me pushtetin. Gjatë procesit (si është përshkruar nga Hannah Arendt) të dobësimit progresiv, në epokën moderne, të pushtetit në format e tija klasike, e vetmja formë pushteti që ende ruan fuqinë e saj e bile edhe përfunduar duke i përfshi dhe zëvendësuar të tjerat, është ajo e shkencës,

Kjo mbetet e vërtetë, edhe nëse që më shumë se një shekull flitet për krizën e shkencës, edhe nëse ka përsheptim më të madh të tendencës për të ikë nga pushteti në të ashtuquajturën shoqëri postmoderne. Kjo nuk duket ta ketë ndryshuar investimin shoqëror në njohurinë shkencore si burim pushteti: përkundër asaj se është demitizuar dhe shpesh nuk vlen shumë, shkenca ruan aurën (që mbese veç e ka rritë) e diçkajës që ka fjalën e fundit. Kështu, shkenca ka pushtet. Bile, ajo është pushteti. Mendoj se është me rëndësi të shohim se si ndodh kjo dhe çfarë pasojash ka. Historikisht, nëse shohim kohën kur shkenca, në kuptimin e saj modern, merr formë, pra kohën e 'revolucionit shkencor', është lehtë me pa se si, në fillim të shkencës moderne, lind problemi i pushtetit. Në njërin anë, është çështje parimi, është 'argumenti nga pushteti' që e synon Galileo. Në anën tjetër, është çështje e ridefinimit të pushtetit de facto, gjë që Kisha e kishte kuptuar mirë. Mohimi i famshëm nga Galileo nuk mjaftonte për ta ndreqë thyerjen që iu shkaktua rendit të vjetër të pushtetit; ai pruri në fuqi nënshtrimit e shkencëtarit si individ kundrejt pushtetit të institucionalizuar politik e fetar, por pushteti i shkencës nuk ishte

më në duart e Galileos ose i lidhur me fatin e tij; ai shtrihej në pushtetin jopersonal të metodës shkencore. Prej atëherë, thuhet të ketë qenë metoda ajo që legjitimizon pushtetin e shkencëtarëve; ata gëzojnë pushtet kognitiv qe del nga metoda shkencore që ka pushtet, dhe është vetëm metoda ajo të cilës i referohen kur vlerësojnë vlefshmërinë dhe kuptimin e aktivitetit të tyre. Kështu, eliminimi i faktorëve të tjerë njerëzor, si marrëdhëniet shoqërore, idealet, bindjet fetare dhe politike, bëhet jo vetëm i pranueshëm, po në fakt kërkohet me themelimin e shkencës dhe të lëndës së shkencës. Përveç kësaj çështjeje të metodës, ka shumë aspekte që shoqërojnë origjinën dhe zhvillimin e shkencës moderne ashtu si e njohim ne, që përcaktojnë kriteret e pushtetit: mbi të gjitha, universaliteti i saj dhe lidhja që ka me të vërtetën. Është mu për shkak të idesë se shkencëtarët, falë metodës, kanë qasje speciale në njohurinë universale dhe në të vërtetën, pse jemi të gatshëm t'u atribuojmë atyre aq shumë pushtet. Të dy këta faktorë i vejnë në pozita të largësisë, superioritetit, dhe në të njëjtën kohë, papërgjegjësisë kundrejt botës dhe njerëzisë, ku ata vërtetojnë mitologjinë e autonomisë së shkencës dhe të lirisë së hulumtimit, si garanci të nënkuptuara të arsyetueshmërisë së ndërmarrjes shkencore si dhe të lirisë së gjithkujt. Konceptet e objektivitetit, neutralitetit dhe realizmit shkencor i takojnë edhe një qarku të tillë mes pushtetit të gjërave dhe pushtetit të shkencës, përmes metodës, dhe synimit të së vërtetës. Evelyn Fox Keller vëren:

Çështja e asaj nëse njohuria shkencore është objektive ose relative, së paku pjesërisht është pyetje mbi pohimin e shkencëtarit për pushtet absolut. Nëse ka vetëm një të vërtetë, dhe ajo është në duart e shkencëtarëve (me fjalë tjera, nëse

shkenca dhe natyra janë një), atëherë pushteti i shkencës është i pandryshueshëm. Por nëse e vërteta është relative, nëse shkenca është e ndarë prej natyrës, dhe e martuar me kulturën (ose 'interesat), atëherë statusi i privilegjuar i këtij pushteti rrezikohet për vdekje. (Tuana 1989:40)

Tash vij në pikën e dytë, që është shkalla e madhe e pasojave të këtij pushteti, sidomos aty ku kemi të bëjmë me relacionin e grave (qenë ato shkencëtare apo jo) me shkencën. Mes elementeve që duhet pasur parasysh lidhur me madhësinë dhe rëndësinë e efekteve të pushtetit shkencor, më i rëndësishmi është se edhe pse e paraqet veten si të pavarur nga kushtëzimi social dhe intelektual, shkenca në vetë është ndërmarrje shoqërore që ndikohet nga, po edhe përcakton, strukturën diskursive dhe marrëdhënëse të formës sociale pjesë e të cilës është. Figura e autonomisë së shkencës është modaliteti i veçantë sipas të cilit rendi shoqëror-simbolik prodhon pushtet me efektivitet shoqëror. Sikur e përmenda tashmë, shumica e akademikeve feministe i kanë drejtuar kritikën kah neutralitetin i supozuar i shkencës, dhe pohimeve të saja që është e liruar vlerash, ashtu që kjo kritikë tash duket me qenë e pranuar gjithandëj. Ka disa merita të pandryshueshme, mes tyre demitizimi i shkencës dhe vënja në pah e seksizmit që ka brenda, duke treguar kështu se paragjykimet zënë rrënjë dhe riprodhohen në nivelin e epistemologjisë së shkencës dhe imazheve të kësaj epistemologjie. Sido që të jetë, kjo kritikë rrezikon të mbetet brenda kufijve të një pozite reaktive, me shumë pak efekt substantiv.

Tashmë kam bërë me dije se, sipas meje, ky kufizim lidhet me dëshirimin për t'u marrë me problemin e pushtetit. Jo se analiza është e pavetëdijshme për rëndësinë e elementit të pushtetit përbrenda shkencës, por shpesh kritika feministe e sheh pushtetin prej një këndvështrimi krejtësisht antagonist, me qëllimin pak a shumë eksplicit që të kalojë në sfidimin thjeshtë të legjitimitetit të saj. Kritika mandej rrezikon të tingëllojë, thënë shkurt antishkencore, dhe tëhuajsuere e grave që e duan dhe e praktikojnë shkencën. Kritika e arsyeshme e pushtetit shkencor si është tash (rrejshëm i natyrshtëm, seksist, autoritariv dhe i papërgjegjshëm) duhet të lidhet me një shqyrtim të pavarur të problemit të pushtetit, që mund të ketë parasysh, në njërin anë, faktin se gratë edhe përfshihen në shkencë por janë edhe jashtë saj, dhe në tjetër, vështirësinë e të menduarit të pushtetit të grave përbrenda shkencës. Këtu mundet me qenë e dobishme t'i referohemi punës teoriko-politike që e kanë bërë gratë për problemin kyç të pushtetit të grave.

Në fakt, një prej kontributeve më të rëndësishme të debatit feminist italian në disa vitet e fundit ka qenë lokalizimi i pengesës kryesore të lirisë e grave për të pasur pushtet, tek mungesa e pushtetit simbolik e jo te shtypja nga burrat. Përvoja politike e lëvizjes feministe ekziston si problem në lidhje me pushtetin, kështu që, për shembull, gruaja ka vështirësi të veçantë si në ushtrimin e pushtetit në emrin e saj dhe në njohjen e pushtetit të një gruaje tjetër. Në nivelin simbolik, pushteti mbetet i lidhur me emrin e babës, duke iu nënshtruar rendit simbolik mashkullor, dhe kur pushtetin e ka trupi i femrës, ajo e paraqet veten si 'zëvendësim', duke vazhduar t'i referohet rendit paternal.



Roli i gruas në ekonominë kosovare

Femra kosovare mund t'i japë vendit jo vetëm potencial të brendshëm zhvillimor, por dhe përparësi krahasuese në rajon, po pati mundësi të barabartë në zhvillim e krijim



Lumir Abdixhiku

Të shumta janë rastet kur një grua kosovare sot bën shembullin e një kontributi esencial në një institucion privat apo publik, madje në raste specifike ajo tregohet shumë herë më kreative, shumë herë më vizionare e shumë herë më inovative se meshkujt. Një ecje e tillë të bën të kuptosh se potencialet e gruas kosovare janë po aq të njëjta sa të meshkujve dhe në një ambient të barabartë konkurrues suksesi i tyre do të ishte lehtësisht evident. Megjithatë në stadin e tanishëm të zhvillimit ekonomik, ku anomalitë biznesore bëjnë përditshmërinë, jo shpesh mund të mburremi me hapësirën, trajtimin apo dhe besimin që shoqëria kosovare ka ndaj rrolit të gruas në ekonomi. Ndoshta normat tona shoqërore dhe sjelljet patriarkale në familje, shoqëri e punë bëjnë pengesat e gruas kosovare sot, apo dhe ndoshta hezitimi i vetë gruas për të marrë iniciativë hendikepon dhe më shumë pjesëmarrjen e saj në fushë konkurruese. Por, në parim, pavarësisht barrierave suksese grujaja kosovare po mori mbështetjen dhe barazinë mund lehtësisht të ecë drejt një participimi më thelbësor në ekonominë e nesërme të Kosovës.

Gratë kosovare janë konsideruar në vazhdimësi si potenciale të pashfrytëzuara të talentit biznesor nga një numër i konsiderueshëm i organizatave vendore e ndërkombëtare. Megjithatë, shfrytëzimi i këtij potenciali ka mbetur larg niveleve të pritshmërisë. Të dhënat tona zyrtare mbi strukturën e bizneseve tregojnë se dallimet mes pronësisë në gjini janë të rëndësishme dhe të dukshme. Femra kosovare sot në përgjithësi ka tendencë që të jetë pronare e bizneseve më të vogla në madhësi, të operojë me kapital shumë herë më të ulët se meshkujt, të themelojë e funksionalizojë biznese në sektorë me vlerë kryesive të vogël dhe të kenë barriera më të mëdha sociale, kulturore dhe ambientale.

Të dhënat nga regjistri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë japin pasqyrën e qartë të këtyre karakteristikave. Këto të dhëna tregojnë se nga gjithsej 65 mijë biznese aktive në vend, vetëm 11% janë nën pronësinë e gjinisë femërore. Ky 11 përqindësh flet shumë po u vë në një krahasim regional dhe më gjerë. Sipas raporteve të OECD-së, mesatarja e vendeve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara është rreth 20%; pra një e pesta e bizneseve në vendet në zhvillim dhe atyre të zhvilluara është nën pronësinë e grave. Kosova dukshëm ka arritur pak më shumë se gjysmën e objektivit të një vendi në zhvillim. Për më tepër, rreth 99.9% e bizneseve nën pronësi të grave kosovare janë biznese mikro, apo me 1 deri në 9 punëtorë. Vetëm 0.01% të tjera kanë madhësi të vogël e të mesme; asnjë të madhe. Diferencat gjinore në karakteristikat e bizneseve vërehen edhe nga numri mesatar i të punësuarve. Përderisa një biznes nën pronësi të meshkujve punëson në mesatare 5.27 punëtorë, një biznes në pronësinë e femrës punëson jo më shumë se 3.07 punëtorë. Një strukturë e tillë në madhësi tregon se ndërmarrja e grave ballafaqohet me pengesa e barriera serioze në rritjen e tyre dhe për më tepër këto barriera janë dukshëm më evidente kur bëhet fjalë për gratë. Pothuajse të gjitha këto biznese nuk arrijnë dot të rriten në madhësi, në punësim apo dhe

qarkullim dhe kjo në vete është hendikepuese për perspektivën afatgjate të tyre.

Të dhënat e fundit në "Rinvest" japin një qartësim më të thuktë në barrierat e rritjes dhe zhvillimit të këtyre bizneseve. Për dallim nga meshkujt, qasja në financa është pengesë që vlerësohet dukshëm më lart nga gratë ndërmarrëse. E njëjta rrezikohet kryesisht nga restriktionet e bankave që kanë ndaj besueshmërisë së grave për të bërë biznes. Për më tepër, mbajtja e patundshmërive kryesisht nën pronësinë e meshkujve dëmton dukshëm mundësinë e gruas kosovare për të pasur një qasje dhe garanci më të lehtë financiare. Aspak më lehtësuese nuk bëhet trashëgimia e pabarabartë gjinore në Kosovë, duke e lënë kështu femrën kosovare qysh në fillim në disavantazh dhe pa shumë kapital e mundësi për të bërë biznes. Një ndihmesë e lehtë në zbutjen e kësaj barriere është treguar nga kreditë e institucioneve mikrofinanciare, të cilat për shkak të shumës së ulët financiare që bartin në vete kanë qenë më të prekshme edhe për ndërmarrëset femra. Barriera po aq e rëndësishme bëhet dhe konkurrenca jo fer e prodhuar kryesisht nga nivelet e informalitetit, korrupsionit dhe forcimit të kontratave, madje për gratë prezenca e trajtimit të jo-barabartë bëhet dhe më e rëndë. Ato në përgjithësi kanë tendencë të jenë më të mbyllura dhe më refuzuese ndaj burokracisë dhe rregullave të ndyta të tregut informal.

Diferencat gjinore bëhen të dukshme edhe në sektorët ekonomik. Femrat kosovare kryesisht janë të orientuara në sektorët e patregtuar, pa potencial të madh rritës dhe pa shumë vlerë të shtuar. Për shembull, deri sa 10% e bizneseve nën pronësinë e meshkujve bëjnë pjesë në sektorin e prodhimit, femrat janë të përfaqësuara me vetëm 3.1% nga totali i tyre në këtë sektor. Numër impresiv i pjesëmarrjes së tyre shihet në sektorët lidhur me punë sociale, shëndetësi apo dhe shitje. Në sektorët si ndërtimtaria, miniera, energjëtika, institucione financiare apo dhe transport, pra në sektorë me vlerë më të lartë, pjesëmarrja e ndërmarrësve femra është zero. Një ndarje e tillë të shumë vend dhe nevojë për ndryshime strukturore në të ardhmen.

Pavarësisht barrierave, rezultate inkurajuese vijnë nga mosha e bizneseve nën pronësinë e grave kosovare. Për t'iu kthyer sërish të dhëna zyrtare, rreth 50% e bizneseve të tanishme nën pronësinë e gruas kosovare kanë filluar aktivitetet e tyre në periudhën 2007-2012, përkund 34% në periudhën 2000-2006. Pjesa e mbetur prej 16% daton që nga paraluftra. Për më tepër, mosha mesatare e ndërmarrësve femra në Kosovë është dukshëm më e ulët se e atyre meshkuj. Kjo strukturë e moshës së bizneseve në pronësi të grave kosovare nënvizon trendin pozitiv të tyre dhe jep një

lloj shprese se pjesëmarrja e gruas në kontributin ekonomik do të vazhdojë të jetë në rritje. Padyshim se hapja e shoqërisë kosovare dhe rritja e tolerancës ndaj gruas ka ngritur pjesëmarrjen saj në biznes. Në të njëjtën frymë, aftësitë menaxheriale dhe operative të femrës kanë prodhuar shpeshherë shembuj suksesi. Kontributi i gruas nuk kufizohet asnjëherë vetëm në pronësi. Ky kontribut nëpërmjet punësimit dhe zotërimit të niveleve menaxheriale e operacionale ka bërë kontributin e vet biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë.

Për të rritur pjesëmarrjen e gruas në biznes, për të ndryshuar nomenklaturën e tanishme gjinore të bizneseve them se një qasje shumëdimensionale është domosdoshmëri e sodit. Kjo qasje shumëdimensionale kërkon përfshirjen intensive të institucioneve, agjencie e asociacioneve biznesore. Një qasje e tillë kërkon një ambient më të favorshëm dhe miqësor biznesor, një qasje më të lehtë në kapital dhe një trajtim më fer shoqëror. Për më tepër, ndryshimi i sjelljeve tona ndaj gruas nëpërmjet rritjes së besimit, dhënies së mundësisë madje dhe mbrojtjes së iniciativës femërore për ndërmarrësi është parakusht për një ambient që krijon vlerë. Femra kosovare ka shumë për të dhënë ekonomisë së Kosovës. Të shumtë janë sektorët (nga ku dalloj tekstilin dhe procedimin e ushqimit) ku femra kosovare i jep vendit jo vetëm potencial të brendshëm, por dhe përparësi krahasuese në rajon. Kosova ka nevojë të ndërtojë mbi këto përparësi. Femra kosovare ka shumë për t'i dhënë Kosovës.

PËRFAQËSIMI I GRUAS NË PUSHTETIN KOMUNAL

Vetëm prej zorit

Në 37 komuna të Republikës së Kosovës, asnjë grua nuk është kryetare komune. Po të mos ishte detyrimi ligjor, grujaja nuk do të ishte e përfaqësuar as në kuvende komunale. Faji për këtë gjendje u adresohet partive politike, por edhe grave që nuk votojnë për gratë

Përfaqësimi i gruas në pushtetin lokal në Kosovë është mjaft i kufizuar. Përveç që nuk kemi asnjë kryetare komune, grave u janë bësuar shumë pak poste udhëheqëse në qeveritë komunale.

Në 37 komuna janë mbi 320 drejtorë drejtorie, ndërsa prej tyre rreth 300 janë meshkuj. Në kuvendet komunale të Republikës së Kosovës, një e treta e këshilltarëve janë gra, por kjo është siguruar me detyrim ligjor.

"Po të mos ekzistonte kuota, në kuvendet komunale nuk do të kishte asnjë femër. Po ju garantoj", thotë Igballe Rogova, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës. Pavarësisht se Ligji për Barazinë Gjinore specifikon se pjesëmarrja e barabartë gjinore në institucione është arritur në rastet kur pjesëmarrja në nivelin e pushtetit është 40 për qind, nuk ka komuna që e kanë zbatuar këtë.

Në tetë komuna të Kosovës, Viti, Novobërdë, Ranillug, Hani i Elezit, Kamenicë, Kaçanik, Kllokot dhe Shtërpce, numri i stafit femra arrin deri në 15 për qind, në total.

Igballe Rogova, e cila mbi dy dekada është e angazhuar për avancimin e të drejtave dhe pozitës së gruas në shoqërinë kosovare, shprehet e dëshpëruar për këtë gjendje.

"Në Kosovë jo vetëm që nuk implementohet ligji, por as vullneti i qytetarëve", tha Rogova.

Që nga zgjedhjet e fundit lokale, zyrtaret më të larta në komunat tona janë tri gra, që mbajnë postet e kryesueseve të kuvendeve komunale në Novobërdë, Pejë dhe Mamushë.

E para nga to që ka fituar këtë post me votat e kolegëve të saj është Shefkije Mehmeti. Ajo drejton me sukses Kuvendin Komunal të Novobërdës. Ajo është nënë e pesë fëmijëve, por e ka përkrahjen e burrit për t'u marrë me politikë.

"Është vështirë për një femër të udhëheqë një Kuvend Komunal", thotë ajo. Megjithatë, ajo ka ambicie që edhe në të ardhmen të merret me politikë dhe nuk e përjashton mundësinë që të kandidohet edhe për kryetare të komunës. Praktika disavjçare e komunave për mosrespektim të Ligjit për barazi gjinore sa i përket punësimit, është ndjekur edhe në procesin e krijimit të komunave të reja – edhe pse me monitorim të rreptë ndërkombëtar.

Kryetari i Komunës së re të Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka treguar se nuk ka të emëruar asnjë drejtoreshë. Ai ka thënë se kur është zgjedhur në pozitën e kryetarit, në komunë i ka gjetur vetëm dy punonjëse femra, ndërsa gjendja vazhdon të jetë e njëjtë.


Edona Hajrullahu, kryeshefe ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit thotë se për këtë vit, Agjencia ka paraparë mbështetjen e grave të cilat janë shërbyese civile përmes ofrimit të 10 bursave për studime master, si dhe do të jap kontributin e saj rreth plotësimit-ndryshimit të Ligjit Zgjedhor dhe harmonizimit të tij me Ligjin për Barazi Gjinore.

Fajin për gjendjen aktuale të pozitës së gruas në institucione e kanë partitë politike.

Nexhmije Kallaba kishte konkurruar për kryetare të Kamenicës, në zgjedhjet e fundit, por nuk kishte mbështetje as nga fshati ku jeton – Rogaçicë. "Nga kjo kam mësuar shumë. Tek ne, femra nuk shihet e denjë për të udhëhequr me komunën apo institucione tjera me rëndësi", thotë ajo. Me strategjinë e re, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës ka planifikuar të punojë me gratë votuese nëpër komuna gjatë tri viteve të ardhshme.

Edhe projekti "Zvicër-Kosovë, përkrahje qeverisjes lokale dhe Decentralizim LOGOS", i cili financohet nga Qeveria Zvicërore dhe zbatohet nga HELVETAS Swiss Intercoopertaion përveç punës së madhe që bën në ndihmë komunave (të regjionit të Gjilanit) që ato të jenë sa më afër qytetarëve dhe të japin atyre shërbim sa më të mirë kontribuon edhe në fushë të barazisë gjinore që si qëllim ka ngritjen e vetëdijes së shoqërisë kosovare për rëndësinë e barazisë gjinore përmes kampanjave, trajnimeve, fondeve dhe dhënies së ekspertizave të ndryshme në këtë fushë.

(KosovaTimes)



INTERVISTË ME MUSA RAMADANI

Ajo që ishte Hida

Në shoqërinë e ngulfatur nga konvencionalizmi, kishte mision për të thyer norma dhe dogma. Si grua, sfidoi letërsinë e dominuar nga burrat. Të tjerët nguteshin për të botuar, ajo i priti të katërdhjetat. Me roman, reagoi ndaj pushtetit absolutist të poezisë. Stili i saj jetësor ishte negacion i artificialitetit publik, klisheve pseudointelektuale dhe perfiditetit kulturor. Prej 1 shkurtit 2012, Hida Halimi do të flasë përmes trashëgimisë së saj letrare. Dhe miqve. Njëri prej tyre është letrari i njohur Musa Ramadani

Artan Muhaxhiri

Nëse do t'ju kërkohet që Hida Halimi ta përshkruanit me pak fjalë, cilat do të ishin ato? Si do t'i flisnit për Hidën dikujt që nuk e ka njohur?



Hida Halimi - poete, romanciere, dramaturge, eseiste, laureate e disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për letërsi, vdiq më 1 shkurt 2012, në Prishtinë. Pjesë nga vepra e saj janë përkthyer në disa gjuhë të huaja. U lind në Radac të Pejës më 20 shtator 1948. Kreu Fakultetin Juridik në Prishtinë. Ka botuar veprat: "Vendlindjen ma zgjodhe ti" (poezi), Plejada, Prishtinë, 1993; "Ai që nuk ishte Fidia" (roman), Buzuku, Prishtinë, 1995; "Njeriu im" (roman), Rilindja, Prishtinë, 1997; "Bijtë e njeriut" (dramë), Faik Konica, Prishtinë, 2003; "Ato letra i shkrova vetë" (novela e tregime), Ars, Tiranë, 2005.

Musa Ramadani: Po të më pyeste ndokush për kolegen e shoqen letrare, do t'i thosha s'para ta lexonte ndonjë libër të saj. Do ta përshkruaja si autore serioze, ndonëse u paraqit vonë në opinion me botime. Do t'i sugjeroja që është fjala për një poetë, eseiste dhe prozatore të veçantë.

Cilat janë kujtimet tuaja më të veçanta për Hida Halimin? Fillimet e njohjes dhe shoqërimin, zhvillimi i karrierave tuaja letrare, botimet e veprave, pikat e pajtimeve dhe mospajtimeve artistike, etj...

Musa Ramadani: Kujtimet nuk janë të pakta. Jemi njohur përmes dorëshkrimit ("Ai që nuk ishte Fidia"), të cilin me patën dhënë miku im i ndjerë, Beqir Musliu dhe bashkëshorti i Hidës, profesori i frëngjishtes, Halit Halimi. Diku në vitin 1996, pak para botimit të ro-

manit të saj të parë. E kam lexuar dy herë dhe e kam rekomanduar: "Ja një Marguerite Duras shqiptare", me bindjen se ishte një zbulim artistik.

Sipas jush, cilat janë cilësitë artistike që e veçojnë krijimtarinë e saj?

Musa Ramadani: Si në poezi, ashtu edhe në prozë, ajo është Hida vetë. Ironia, alegoria dhe grotesku shprehin modernitetin e krijimeve të saj, madje edhe në shkrime eseistike.

Në çfarë mënyre e spikatë krijimtarinë e saj rolin e gruas krijuese në shoqëri? A ishte ajo model i gruas moderne intelektuale shqiptare?

Musa Ramadani: Shkrimtarja e njohur, në një mënyrë, mund të ishte edhe model i gruas moderne (ka lënë pas vetës veprat letrare, por edhe fëmijët Fisnikun e Zgjinin). Ani pse me profesion juriste, kultura e saj letrare, pamore e teatore ishin të një shkalle të atillë që e shquanin si intelektuale.

Cila është vepra e saj më e preferuar nga ju? Dhe anasjelltas: a ju ka thënë ndonjëherë se cila ka qenë vepra juaj që asaj i ka pëlqyer më së shumti?

Musa Ramadani: Për mendimin tim, përveç vëllimit poetik "Vendlindjen ma zgjodhe ti", nga librat me tregime, ese dhe romane vendin qendror e zë "Ai që nuk ishte Fidia".

Nga veprat e mia, Hida më së shumti e pëlqente "Antiprocesionin", për të cilin ka pasë shkruar një pasthënie të shkurtë.

Ajo kishte një sens të madh humorit, i cili shpesh reflektohej edhe në poezinë e saj. Por, kishte edhe poezi trishtimi... A mund të njihet Hida e vërtetë përmes poezive dhe romaneve të saja?

Musa Ramadani: Si person, individ, krijuese, Hida jo vetëm që kishte sens për humor, por ishte edhe një tip i veçantë. Pak rebele, pak kryengritëse, pak hazardere në jetën e përditshme, por edhe në krijimtarinë artistike. Sharmi i saj gjatë bisedave, spirituoiziteti i lindur, një lloj optimizmi (jetësor) gërshtuar me pesimizmin (intelektual), mpleksnin në vete qëndrimin kritik - e pse jo edhe vetëkritik - për shumë probleme, çështje e ide.

Si u ndjetë kur morët lajmin për vdekjen e saj?

Musa Ramadani: Lajmin për

humbjen (nuk them vdekjen) e mora në rrugë, diku nga ora 16:30. Isha në pritje të autobusit urban për të shkuar në shtëpi. Me informoi një gazetare, e cila më telefonoi për t'ma kërkuar një deklaratë për Hidën. Fola me dhimbje, pikëllim e befasia të thellë. Ato ditë me duhej të pinim espresso te "Edi 2" dhe të bisedonim (pas një muaj mungese të saj). Ajo iku si meteor.

Hida Halimi vdiq në të njëjtën ditë me poeteshën nobeliste Wislawa Szymborska, krijimtarinë e së cilës e pëlqente. Koincidençë kozmike? Fatum?

Musa Ramadani: E di se e ka lexuar Szymborska'n. Megjithatë, ajo më së shumti kishte nëpër duar dhe merrej me autorë të regjionit gjuhësor francez. E fliste, lexonte dhe e shkruante për mrekulli frëngjishten. Shumë kemi diskutuar për autorët e romanit të ri francez (Nathalie Sarraute, A. R. Grillet dhe Michel Butor), përse nuk përkthehen edhe në gjuhën shqipe. Por edhe për poetë surrealistë, romancierë avangardë dhe filozofë ekzistencialistë (Sartre, Camus, Cioran)...

Konstatimi juaj përkritazi me nobelisten polake është metafizik. Unë dhe Hida ishim në pritje të datës 23 dhjetor 2012.

Poezia filmike e Blerta Zeqirit

Bekim Lumi

Si ta bëjmë film rrëfimin tonë të luftës? Kjo është një pyetje, të cilën, me të drejtë, vazhdojmë t'ia parashtrijmë vetes tani e sa vjet, por në të cilën ende nuk kemi dhënë përgjigje. E, pra, përkundër luftës së saj të tmerrshme, me copëza, tablo e imazhe nga më të mnershmet, më ngjethëset e më tragjike, Kosova, krejt paradoksalisht, vazhdon të mos e ketë ende, në kuptimin e vërtetë të fjalës, filmin e saj të luftës. Përderisa, bie fjala, boshnjakët tashmë luftën e tyre e kanë përjetësuar, madje me shumë fisnikëri artistike, në një mori filmash, me disa nga të cilët ata i kanë prekur edhe majat e kinematografisë botërore, kineastët kosovarë vazhdojnë të bëjnë sehir, duke pritur që idetë për filmin e tyre të luftës të pikojnë nga qielli.

Në të vërtetë, filma për luftën në Kosovë janë bërë. Këta filma janë bërë edhe nga kineastët kosovarë. Për fat të keq, me formatin dhe fakturën e tyre përmbajtësore e estetike, këto krijime filmike nuk i kanë tejkaluar dot limitet e mendësisë provinciale 'artistike'. Me rrëfimet kryesisht jokreative, por edhe me mënyrën e realizimit të tyre thellësisht konvencional, këto krijime kanë filluar dhe kanë përfunduar kryesisht si projekte të dështuara kinematografike. Ndërkaq, kur jemi të dështimi i tyre, duhet thënë shkoqyr se, para se për shkaqe të natyrës buxhetore, ato kanë dështuar për shkak të mungesës së kreativitetit artistik.

Një përjashtim në krejt storiën e mërzitshme filmike kosovare të mbasluftës shënon filmi i metrazhit të shkurtër 'Kthimi' i regjisores Blerta Zeqiri, i cili, kohë më parë, krejt befshëm e mrekullisht, nga Sundance Film Festival, një nga tri - katër festivalet më të rëndësishme botërore, u kthye me çmimin e parë e më të rëndë-

sishëm në krejt historinë 43-vjeçare të kinematografisë kosovare. Në të vërtetë, 'Kthimi' është vazhdimësi e suksesit të mëhershëm të Blertës me filmin 'Exit', i cili, po me temën e luftës, nga festivale të tjera ndërkombëtare, është kthyer me disa çmime të tjera jashtëzakonisht të rëndësishme.

Ndryshe nga çfarë ka ndodhur deri tani në ata pak filma kosovarë me temën e luftës, në të cilët, përmes rrëfimeve jashtëzakonisht konvencionale, më shumë se copëzat e dhembjes së vërtetë tragjike të njerëzve të këtij nën-qielli, janë paraqitur disa nga tablotë e përgjithësuara 'epike' të kësaj lufte, filmi 'Kthimi' i Blerta Zeqirit, përmes temës së të zhdururve e të dhunimit të femrave shqiptare nga ushtarët, paramilitarët dhe policët serbë, është më shumë se vetëm një rrëfim rrëqethës, i cili pa zhurme, pa sforcim dhe pa as më të voglin intonim patetik, në një mënyrë të 'lehtë' dhe jashtëzakonisht spontane, na e sjell mbase copëzën më intime e më të prekshme të dhembjes nga rrëfimi ynë i luftës.

E qartë, 'Kthimi' nuk vjen me pretendimin për të na e shfaqur në plotninë e saj krejt temën tonë të luftës. Në të vërtetë, duke u fokusuar në një apo dy nga tablotë më prekëse të kësaj lufte, jo aq për temën e këtij rrëfimi sa për minimalizmin dhe mënyrën e trajtimit të saj regjisorial, filmi 'Kthimi' nuk përkon në asnjë kontekst me klishetë kosovare për filmimin e luftës. Në vend se me imazhet e shtëpive të djegura, në vend se me tablotë e përgjakura të njerëzve të vranë, të masakruar ose të përdhunuar, 20 minutat e këtij rrëfimi filmik janë të mbushur me pamje nga më të zakonshmet, gati deri në dokumentaritet, të jetës së përditshme të një çifti bashkëshortor, një burri (Lulzim Bucolli) dhe një gruaje (Adriana Matoshi), të cilët, duke mos ditur gjë për fatin e njëri



tjetrit, apo duke e pandehur njërin apo tjetrin për të zhdukur, ribashkohen disa vjet mbarimit të luftës.

Krejt ajo që, në shikim të parë, mund të duket si një happy end i këtij çifti përmbysset shumë shpejt me të kuptuar se, përveç djalit (Bokjen Matoshi) nga bashkëshortësia e tyre, ata tashmë kanë edhe një vajzë (Nina Govori) të ngjizur nga përdhunimi që paramilitarët serbë kanë bërë me gruan gjatë ditëve të luftës. Për ironi, këtë gjë i shoqi, i sapokthyer nga burgu, e kupton gjatë një bashkëbisedimi spontan me të shoqen në shtratin bashkëshortor. Pa ndonjë ngarkesë të theksuar dramatike, pa asnjë sforcim emotiv, siç ndodh rëndom në filmat tanë, ky episod i rëndë i këtij çifti shfaqet me krejt barrën e tij të vërtetë përmes një situatë të rastësishme. Dhe, çu-

ditërisht, kjo, bashkë me sekuenat e fundit filmike, në vend se ta zvogëlojë apo ta amortizojë, e shton dhe e zmadhon edhe më shumë suspansin dramatik të këtij filmi.

Gjithsesi, filmi 'Kthimi' nuk do të ishte ky që është pa praninë aq të 'padukshme', të 'pandjeshme' dhe aq joiimponuese sidomos të aktore Adriana Matoshi. E thjeshtë, e saktë, spontane dhe pafundësisht magjike, me pamjen e saj të pafajshme dhe me lojën e saj ekspresive, ajo, në këtë film, jo vetëm kur qan, por edhe kur qesh, ngjan në një ikonë të gjallë njerëzore të pikturuar me ngjyrat e dhembjes, të lotit, të trishtimit e të pikëllimit. Në të vërtetë, falë lojës ekspresive të Adriana Matoshit, 'Kthimi' po aq sa kreacion regjisorial, është, gjithashtu, edhe një kreacion i fuqishëm aktorial.

Në njëfarë mënyre, edhe pse në formë fragmentare, me filmat e saj, në qendër të të cilëve vazhdon të jetë drama ngjethëse e njerëzve tanë në ditët e sezonës tonë kolektive, regjisoria Blerta Zeqiri, ngadalë, por sigurt dhe kreativisht bindshëm, larg çdo sforcimi 'epik' apo patetik, po e krijon filmikisht rrëfimin tonë të luftës. Mund të thuhet, prandaj, se filmat e saj 'Kthimi' dhe 'Exit' janë prolog i këtij rrëfimi, të cilin ajo, me shumë elegancë, delikatesë dhe mjeshtri artistike, përmes dorëshkrimit të saj regjisorial, tashmë e ka plasuar dhe përjetësuar në poezinë e saj filmike. Me të drejtë, mbas Sundance Film Festival dhe suksesit të saj me filmin 'Kthimi', mund ta presim pjesëmarrjen e saj nëpër festivale të tjera botërore dhe kthimin e saj të bujshëm në Kosovë jo vetëm me 'Kthimin'.

PERISKOPI

Një pyetje që nxit fantazinë

Pyetje për 8 mars: Sikur të kishit pushtetin politik çfarë do të ndryshonit së pari? Ja si përgjigjen disa nga personalitetet femra të Kosovës në rubrikën 40 pyetje - 40 përgjigje



Enver Robelli

Tani një vit në faqet e "Kohës Ditore", çdo të mërkure, personalitete të ndryshme përgjigjen në 40 pyetje, të cilat shpesh ofrojnë një pasqyrë mbi godinën e mendimeve të secilit/secilës. Në një shoqëri të dominuar nga meshkujt, siç është kjo e Kosovës, gjithsesi është e pritshme që ata të pretendojnë se i dinë të gjitha përgjigjet, sidomos kur është fjala për punët e pushtetit, këtu ata vërtet mendojnë se janë në majtë të kajmakut të mençurisë. Por si do të ishte Kosova sikur pushteti të ishte vetëm në duart e femrave? Një pyetje që nxit fantazinë. Pyetja e 20-të e rubrikës 40 pyetje - 40

përgjigje është kjo: Sikur të kishit pushtetin politik çfarë do të ndryshonit së pari? Ja si janë përgjigjur personalitetet femra në 12 muaj e fundit në faqet e "Kohës Ditore":

Alberta Troni, pianiste

"Sigurinë dhe mirëqenien e popullatës, shëndetësinë, sigurimet shëndetësore, cilësinë e arsimit, ekonominë - decentralizimin e saj në komuna dhe fshatra të Kosovës, higjienën dhe mirëmbajtjen e qytetit, stimulimin për decentralizim të popullatës në tërë Kosovën. Prishtina nuk ka kapacitet ta përpijë tërë Kosovën, si duket, nuk po i vjen radha kulturës edhe pse unë vij nga sfera e kulturës, por ka aq shumë për t'u bërë në këtë vend, dhe pa kode dhe etikë urbane zhvillimi kulturor është edhe më tutje i largët".

Anamari Repi, gazetare, zëvendës drejtoreshë e RTK-së

"Të gjithë ministrat, menaxherët,

shefat dhe këshilltarët e tyre".

Ardita Statovci, pianiste

"Muzika është pakrahasimisht më e bukur se politika. Emocioni që shpreh ajo, është i drejtpërdrejt, i sinqertë dhe e arrin automatikisht thelbin në qenien e njeriut. Nuk do e ndërroja kurrë me politikën".

Eliza Hoxha, arkitekte

"Idenë që nga shteti vetëm duhet të marrësh apo të presësh".

Sanije Matoshi, mexosoprane

"Ngritjen e vetëdijes që shteti është i yni. Që ligji është mbi të gjitha. Pa ligj dhe respektim të tij - s'ka shtet dhe mirëqenie".

Shkëndije Geci, ambasadore në Budapest

"Arsimimi i mirëfilltë është shtylla e një shoqërie të shëndoshë dhe përparimtare. Por, krahas kësaj edhe edukata, e cila fillon në familje dhe depërton në shoqëri. Këtu duhet të punojmë më shumë si shoqëri dhe

si vend".

Shpetime Kamberi, arkitekte në Zvicër

"Bindjen që pushteti është zgjidhja e vetme për ndryshim. Çdo individ duhet të vetëdijësohet dhe të kontribuojë aktivisht në zhvillimin e vendit".

Violeta Rexhepagiq, gazetare dhe muzikante

"Çdo gjë! Duke filluar nga higjiena, pastaj dënimet për hedhje të letrës në rrugë, burgosje të njerëzve të korruptuar e deri te rritja e rrogës së vogël të atyre që punojnë në arsim".

Vjosa Osmani, deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës

"Ka shumë gjëra që duhen ndryshuar si pasojë e keqeverisjes së tanishme. Ndër kryesoret është përmirësimi i imazhit të Kosovës, dhe krahas saj thithja e investimeve të huaja, hapja e vendeve të reja të punës dhe dhënia e hapësirës më të

madhe për të rinjtë në vendimarrje".

Vlora Çitaku, ministre e integriteteve evropiane

"Unë kam sado pak pushtet politik, dhe po mundohem ta bëj punën time. Ajo që më pengon më së shumti tek ne në Kosovë është aftësia për t'i besuar më parë një lajmi të keq sesa një lajmi të mirë dhe paragjykimet. Po e qartë, këto nuk ndryshohen me pushtet politik, por me ndryshimin e referencave kulturore".

Yllka Gashi, aktore

"Edhe pse kursesi nuk e shoh veten si personalitet që do të "politizohesh" ndonjëherë, nëse do e kisha atë mundësi do të ndryshoja shumëçka. E para dhe kryesorja do të ndërroja formën e zgjedhjes së presidentit. E dyta dhe jo më pak e rëndësishme do ta bëja të obligueshme përdorimin e fjalëve "të ju lutem", "më falni", "faleminderit" në institucione e pastaj edhe në fjalorin dhe komunikimin e përditshëm!"

Ambasadorja jonë

Për vajzën që nuk di për barriera. Për ëndrrën olimpikë dhe ambasadoren e vërtetë të këtij vendi

Sportistët e Kosovës janë duke u përpjekur që t'i kalojnë pengesat politike, të cilat i mbajtën larg për afër dy dekada nga pjesëmarrja në arenën ndërkombëtare. Dhe kështu larg edhe nga ëndrrat. Kosova shpall pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008, pas një konflikti të gjatë dhe përpjekjeve për një marrëveshje paqësore. Por edhe pas katër vjet pavarësimi, aplikimet e Kosovës bllokohen ose refuzohen nga shumë organizata sportive ndërkombëtare. Pengesa kryesore vjen nga argumentet politike.

Por nuk është e tëra zi. Kemi diçka edhe nga e bardha. Edhe pse Serbia po bën gjithçka që është e mundur për t'i ndaluar njohjet e shtetit të Kosovës dhe për të penguar sportistët kosovar nga prezantimi ndërkombëtar, Kosova dy vjet më parë e ka bërë një fitore simbolike. Dhe këtë falë një vaje simpatike Majlinda Kelmendit. 18-vjeçarja Majlinda Kelmendi fitoi medaljen e parë të artë në xhudo, në nivelin ndërkombëtar në Kupën e Botës.

Në fund të tetorit të vitit 2009, në stadiumin Pierre de Coubertin të Parisit, himni i Kosovës u intonua për herë të parë gjatë ceremonisë së ndarjes së shpërblimeve në Kupën e Botës. "Nuk e prisja se do ta dëgjoja himnin tim", kujton Majlinda, ende e ekzaltuar nga ai moment. Kelmendit i ishte mundësuar pjesëmarrja nën flamurin e Federatës Ndërkombëtare të Xhudos në pritje të njohjes së Kosovës nga organizatat ndërkombëtare sportive.

"Ishte një moment historik. Pa marrë parasysh numrin e turneve në të cilët kam marrë pjesë, mendoj se atë moment do ta kujtoj gjatë tërë jetës", shton Majlinda, e cila ushtron 4-5 orë në ditë në ekipin e saj Ippon nga Peja.

Vitin e kaluar pasi fitoi medaljen e artë në Kupën botërore në kategorinë A që është mbajtur në Romë dhe medaljen tjetër të artë në Kupën Botërore, që u



mbajt në Bjellorusi, me pikët e fituara Majlinda Kelmendi siguroi edhe matematikisht pjesëmarrjen në Olimpiadën 'Londra 2012'.

Por ende nuk është e sigurt a do të përfaqësojë Kosovën për shkak se nuk është e pranuar në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Një alternativë është Shqipëria, kurse mund të garojë edhe nën flamurin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC).

"Sigurisht se dëshira ime është që të marrë pjesë me Kosovën. Ndoshta nuk do të jem në gjendje të prezantohem me flamur të Kosovës, por të gjithë e dinë se jam nga Kosova. Edhe pse ndoshta do të garoj për ndonjë shtet tjetër, të gjithë do ta dinë se kjo ka ndodhur jo me dëshirën time, por për shkak të

pamundësisë për të marrë pjesë për Kosovën. Shpresoj që mos t'i zhgënjë të gjithë këta njerëz dhe do të jap maksimumin dhe të ndodhë ajo që të gjithë shpresojmë", Majlinda për Reuters.

Ekipi i 21-vjeçares tashmë ka nxjerrë edhe sloganin - "Majlinda në tri Olimpiada".

"Majlinda do të jetë vetëm 21 vjeç kur do të marrë pjesë në 'Londra 2012'. Më 2016, ajo do të jetë 25 vjeçe, ndërsa më 2020 do të jetë 29 vjeçe, moshë e preferuar e xhudistëve", sqarohet në uebsajtin zyrtar të saj domethënia e këtij slogani, i cili mbi të gjitha për qëllim ka t'i vetëdijësojë bizneset e sektorit privat që Majlinda ka nevojë të mbështetet akoma më shumë financiarisht për ta prezantuar sa më mirë Kosovën në 'Londra

2012'.

Përkrahja e Majlindës në arritjen e këtij qëllimi do të jetë një shembull i mirë për të gjithë Kosovarët me ëndrra të mëdha. Ato mund të arrihen.

Xhudo më shumë se hobi

Nëna e Majlindës, Fikretja, në të 50-at, ishte e para në këtë familje që kishte veshur kimono. Fikretja kishte ushtruar karate për disa muaj në vitet e 70-ta, por kjo përvojë ishte jetëshkurtër pasi që prindërit e saj nuk ia miratuan këtë hobi.

"Gjërat janë ndryshe për Majlindën", ka thënë Fikretja për revistën "Kosovo 2.0".

Së bashku me burrin e saj, Ismetin, i cili kishte luajtur futboll profesional, ata gjithmonë kanë

nxitur fëmijët e tyre që të kenë ndonjë hobi.

"Por, për Majlindën xhudo është më shumë se sa një hobi", thotë Fikretja.

"Ajo ka mbështetjen tonë të plotë pasi që dëshira e saj është të merret me xhudo".

Prindërit e saj nuk e patën problem që vajza e tyre e vogël stërviste për orë të tëra në një palestër të dominuar nga meshkujt.

Për dallim nga Majlinda, vajzat e tjera përshtaten me mentalitetin e shumicës në qytet. Peja, një qytet në perëndim të Kosovës, ka rreth 100.000 banorë. Barrierat sociale ende janë prezent në këtë ambient, ku mendimi i të tjerëve qon peshë.

Edhe pse prindërit ia kanë lejuar që të merret me sport përkundër vështirësive, Majlinda duhet që të përfundojë shkollën patjetër.

"Është me rëndësi që ajo të ketë një diplomë pasi që atë do ta ketë përgjithmonë", thotë Fikretja pasi pranon se qanë kurdo që e sheh bijën e saj duke fituar ndeshjet.

Majlinda ia ka arritur që të jetë e shkëlqyeshme edhe në shkollë. Përkushtimi ndaj çdo gjëje që bënë është çelësi i suksesit të saj.

"JO" Azerbajxhanit

Me angazhimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, Majlinda Kelmendi do të vazhdojë ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në çdo garë të ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ajo ka refuzuar një ofertë joshëse të Azerbajxhanit. Kelmendit dhe trajnerit të saj Driton Kukës, autoritetet e shtetit të Azerbajxhanit i patën ofruar secilit paga mujore në vlerë pesë mijë euro dhe shumë përfitime të tjera. Por, pas mbështetjes që i ka dhënë Ministri i Sportit, Memli Krasniqi si dhe ndihmës nga sektori privat është arritur që të sigurohen të gjitha kushtet që Majlinda të garojë me flamurin e Kosovës në të gjitha garat ndërkombëtare.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Centre

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga: